


Libri i teuhidit

për fillestarë dhe të rinjë



DR. ABDULAZIZ IBËN MUHAMED A'LI
ABDULATIF

Dr. Abdulaziz ibën Muhamed A'li Abdulatif

LIBRI I TEUHIDIT

Për fillestarë dhe të rinjë

Titulli: LIBRI I TEUHIDIT - Për fillestarë dhe të rinjë

Titulli në origjinal: كتاب التوحيد للناشئين والمبتدئين

Autor: Dr. Abdulaziz ibën Muhamed A'li Abdulatif

Përktheu: Mr. Shpend Zeneli

Redaktoi: Hekuran Helshani

Parathënia e autorit

Lavdfalënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të gjithësisë, ndërsa përshëndetjet dhe bekimet qofshin për profetin më të dalluar, për familjen, e gjithë shokët e tij.

Ky libër është për një shkallë fillestare mbi njëshmërinë e Allahut dhe kushtet e besimit, ku është synuar shpjegimi i çështjeve më me rëndësi rreth njëshmërisë; në formë të shkurtuar, me një stil të qartë të fjalive, që i përshtatet kësaj kategorie. Ky libër ka përmbledhur një numër të argumenteve mbi çështjet e teuhidit, të shtjelluara në një mënyrë të bukur dhe me informata të renditura, duke shtuar disa aspekte edukative dhe etike të kësaj lëmie.

Ky libër është i përshtatshëm për fillestarë dhe të rinjë.

E lusim të Plotfuqishmin Allah që ta bëjë këtë libër të dobishëm, e të sinqertë vetëm për hir të Tij, të jep bereqet në mundin e shërbetorëve të islamit, e të na furnizoj të gjithëve me synim të pastër dhe pasim të së vërtetës.

Paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi të dërguarin tonë, Muhamed, mbi familjen e tij dhe mbi gjithë shokët e tij.

Autori

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit

Hyrje

Pyetje rreth teuhidit për fillestarë (1):

Nuk ka Zot tjetër (që meriton të adhurohet) pos Allahut

Muhamedi është i dërguari i tij

Zoti im është Allahu

Unë e adhuroj Zotin tim

Unë e dua Zotin tim

P. 1 - Kush është Zoti yt?

1 - Zoti im është Allahu.

P. 2 - Kush të krijoi?

2 - Allahu është ai që më krijoi dhe i krijoi të gjithë njerëzit.

P. 3 - Kush e krijoi natën dhe ditën, diellin dhe hënën?

3 - Allahu e krijoi natën dhe ditën, diellin dhe hënën.

P. 4 - Kush e krijoi tokën në të cilën ecim?

4 - Allahu e krijoi tokën në të cilën ecim.

P. 5 - Kush i krijoi detet dhe lumenjtë që rrjedhin?

5 - Allahu i krijoi detet dhe lumenjtë që rrjedhin.

P. 6 - Kush e lëshon shiun nga qielli?

6 - Allahu e lëshon shiun nga qielli.

P. 7 - Kush i krijoi drunjt dhe prej tyre nxori frytet?

7 - Allahu i krijoi drunjt dhe nxori prej tyre frytet.

Pyetje rreth teuhidit për fillestarë (2):

Unë e adhuroj Allahun

Unë e dua Allahun

Allahu i krijoi njerëzit që ta adhurojnë Atë dhe t'i binden Atij

Adhurimi dhe bindja ndaj Allahut janë të obligueshme për të gjithë njerëzit

P. 1 - Cila është feja jote?

1 - Feja ime është Islami.

P. 2 Ç'është Islami?

2 - Islami është Njësimi i Allahut, bindja dhe braktisja e kundërshtimit të urdhrave të Tij.

P. 3 - Cili është themeli i Islamit?

3 - Themeli i Islamit është dëshmia se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij.

P. 4 - Përse ngrihemi për t'a falur namazin kur e dëgjojmë ezanin?

4 - Sepse namazi është shtyllë prej shtyllave të Islamit, dhe njeriu nuk mund të jetë mysliman vetëm se me kryerjen e tij.

P. 5 - Cili është i dërguari të cilin Allahu e dërgoi tek ne?

5 - I dërguari të cilin Allahu na e dërgoi është Muhamedi - paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!

P. 6 - Pse Allahu e dërgoi Muhamedin – paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të – tek të gjithë njerëzit?

6 - E dërgoi tek të gjithë njerëzit që t'ua mësojë atyre Islamin.

P. 7 - Në çfarë thërriste i dërguari Muhamed – paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të?

7 - I dërguari – paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të – thërriste në adhurimin e Allahut – Një – dhe largimin nga adhurimi i dikujt tjetër.

Njohja e tri themeleve:

Jam i kënaqur që zoti im është Allahu, që feja ime është Islami, dhe që Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) është i dërguari i Tij dhe lajmëtari.

E kemi për detyrë t'i njohim tri themele të fesë:

Njohja e Zotit të madhëruar, njohja e fesë dhe njohja e të dërguarit

Themeli i parë: Njohja e Zotit:

1 - Zoti im është Allahu, Krijuesi, Sunduesi, Drejtuesi; Allahu thotë: **“Allahu është krijues i çdo gjëje.”**¹

2 - E njoh Zotin tim nëpërmjet argumenteve dhe krijesave të Tij; Allahu thotë: **“Nga faktet e madhështisë së Tij janë nata, dita, dielli e hëna.”**²

3 - Allahu është i adhuruari, i vetmi që meriton të adhurohet, Një dhe i pa rival; Allahu thotë: **“O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i cili ju krijoi juve edhe ata që ishin para jush ashtu që të jeni të devotshëm (të shpëtuar).”**³

P. 1 - Për çfarë të ka krijuar Allahu?

- Më ka krijuar që ta adhuroj Atë, Allahu thotë: **“Nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit pos që të më adhurojnë.”**⁴

P. 2 - Ç'është adhurimi i Tij?

- Adhurimi i Tij është: Njësimi i Tij dhe bindja ndaj Tij.

P. 3 - Cili është kuptimi i fjalës “La ilahe il Allah”?

- Kuptimi i kësaj fjale është se: Nuk ka të adhuruar me meritë pos Allahut.

Themeli i dytë: Njohja e fesë:

1 - Islam është njësimi i Allahut dhe bindja ndaj Tij, largimi nga kundërshtimi i urdhrit të Allahut; Allahu thotë: **“Kush ka fe më të mirë se ai që singerisht i është bindur Allahut dhe, duke qenë bamirës.”**⁵

¹ Sureja Zumer, 62.

² Sureja Fusilet, 37.

³ Sureja Bekare, 21.

⁴ Sureja Dharijat, 56.

⁵ Sureja Nisa, 125.

2 - Islami është feja që Allahu zgjodhi për të gjithë njerëzit; Allahu thotë: “... **zgjodha për ju islamin fe.**”⁶

3 - Islami është fe e mirësisë, lumturisë dhe hareshë, Allahu thotë: “**Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që i është dorëzuar Allahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërzen.**”⁷

P. 1- Sa janë kushtet e Islamit dhe cilat janë ato?

- Kushtet e Islamit janë pesë, ato janë:

1. Dëshmia se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij.

2. Falja e namazit.

3. Dhënia e zeqatit.

4. Agjërimi i Ramazanit.

5. Haxhi në shtëpinë e Allahut, për atë që ka mundësi.

Themeli i tretë: Njohja e të dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të):

1 - I dërguari im është Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

2 - Allahu e dërgoi Muhamedin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) tek të gjithë njerëzit, për t’ua mësuar atyre Islamin.

3 - E kam për detyrë që ta respektoj të dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të); Allahu thotë: “**Çka t’ju japë Pejgamberi, atë merrnie, e çka t’ju ndalojë, përmbanju.**”⁸

Themelet e besimit tonë janë tri

Njohja e Zotit të madhëruar, njohja e fesë dhe njohja e të dërguarit

Themeli i parë: Njohja e Zotit të Lartmadhëruar:

1 - Zoti ynë i Lartmadhëruar është Krijuesi i qiejve dhe i tokës; Allahu thotë: “**Vërtet, Zoti juaj, Allahu, është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh. Vërtet, Zoti juaj, Allahu, është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh.**”⁹

⁶ Sureja Maide, 3.

⁷ Sureja Bekare, 112.

⁸ Sureja Hashr, 7.

⁹ Sureja Araf, 54.

2 - Zoti ynë krijoi njeriun, e krijoi atë në formën më të mirë; Allahu thotë: **“Vërtet, Ne e krijuam njerin në formën më të bukur.”**¹⁰

3 - Zoti ynë është ai i Cili qeverisë; Allahu thotë: **“Ai është që udhëheqë çështjen (e të gjitha krijesave) prej qiellit në tokë.”**¹¹

4 - Allahu krijoi xhinët dhe njerëzit për ta adhuruar; Allahu thotë: **“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë.”**¹²

5 - Allahu na urdhëroi që të mos u besojmë (bindemi) djajve por t’i besojmë Atij; Allahu thotë: **“E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje.”**¹³

6 – Lidhja më e fortë është “La ilahe il Allah,” që do të thotë: Nuk ka të adhuruar që meriton të adhurohet me të drejtë pos Allahut.

Themeli i dytë: Njohja e fesë Islame:

1 - Feja jonë është islami, Allahu nuk pranon nga dikush fe tjetër; Allahu thotë: **“E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t’i pranohet.”**¹⁴

2 - Shkallët e islamit janë tre: Islami, imani dhe ihsani.

- Islami është: Nënshtrimi ndaj Allahut të Madhëruar me Njeshmëri, bindje e respekt, dhe largimi nga shirku dhe ithtarët e tij.

- Imani është: Të besosh Allahun, melaiket, librat, të dërguarit, Ditën e Fundit dhe në caktimin e tij, i mirë apo i keq¹⁵ qoftë.

- Ihsani është: Të adhurosh Allahun sikurse je duke e parë, sepse edhe nëse ti nuk e sheh atë, Ai të sheh ty.

Themeli i tretë: Njohja e të dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të):

1 – Ai është Muhamedi, i biri i Abdullahut, i biri i Abdulmutalibit, nga fisi Hashimij, e pastaj Kureshij (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i dërguari më i zgjedhur dhe vula e të dërguarve.

¹⁰ Sureja Tin, 4.

¹¹ Sureja Sexhde, 5.

¹² Sureja Dharijat, 56.

¹³ Sureja Bekare, 256.

¹⁴ Sureja Ali Imran, 85.

¹⁵ (Shënim nga përkthyesi) Kur thuhet “caktim (kader) i keq” kjo nënkupton se ajo që e ka caktuar Allahu në të vërtetë nuk është e keqe, mirëpo karshi raportit të këtij caktimi me njeriun duket e keqe, prandaj nëse ajo bie mbi të mirët është pastrim për ta, ndërsa nëse bie mbi të këqijtë është drejtësi.

2 - I dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) kumtoi këtë fe, na urdhëroi me çdo të mirë dhe na ndaloi nga çdo e keqe.

3 - Jemi të obliguar ta kemi shëmbëlltyrë dhe ta pasojmë atë; Allahu thotë: **“Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut.”**¹⁶

4 - E kemi për obligim që dashuria jonë për të të jetë primare, para dashurisë së nënave dhe baballarëve tanë, por edhe para gjithë njerëzimit; I dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Nuk ka besuar askush nga ju, përderisa të mos jem më i dashur te ai se babai i tij, fëmija i tij dhe gjithë njerëzit.” Dashuri ndaj tij është pasimi dhe respektimi i tij.

Dëshmoj se nuk ka zot tjetër pos Allahut

Dhe dëshmoj se Muhamedi është i dërguar i tij

1 - Kuptimi i dëshmisë se nuk ka zot tjetër pos Allahut është: nuk ka të adhuruar me meritë pos Allahut.

2 - Adhurimi (ibadeti) është: “Gjithë ajo që Allahu e dëshiron dhe është i kënaqur me të, prej fjalëve dhe veprave.”

3 - Adhurimet janë të shumta; prej tyre janë: lutja, frika, mbështetja, namazi, përmendja e Allahut, respektimi i prindërve, etj.

Argument për lutjen është fjala e Allahut të Lartmadhëruar: **“Zoti juaj ka thënë: “Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë në nënçmuar në xhehennem.”**¹⁷

Argument për frikën është fjala e Allahut: **“... po ju mos u frikësoni prej tyre, frikësomuni Mua, nëse jeni besimtar.”**¹⁸

Argument për mbështetjen është fjala e Allahut: **“Dhe vetëm Allahut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë të sinqertë.”**¹⁹

Argument për namazin është fjala e Allahut: **“Faleni namazin e mos u bëni nga idhujtarët.”**²⁰

Argument për përmendjen e Allahut është fjala e Allahut: **“O ju që besuat, përkujtoni Allahun sa më shpesh.”**²¹

¹⁶ Sureja Ahzab, 21

¹⁷ Sureja Gafir, 60.

¹⁸ Sureja Ali Imran, 175.

¹⁹ Sureja Maide, 23.

²⁰ Sureja Rum, 31.

Argument për respektimin e prindërve është fjala e Allahut: **“Ne e urdhëruam njeriun t’u bëjë mirë prindërve të vet.”**²²

4 - Manifestimi i të gjitha llojeve të adhurimit Allahut, Një dhe të pa rival; e kush vepron diç nga adhurimet për dikë tjetër pos Allahut ai është jobesimtar; Allahu thotë: **“E kush adhuron (bashkë) me Allahun edhe ndonjë zot tjetër, për të cilin nuk ka kurrfarë fakti, përgjegjësia e tij është para Zotit të vet, e mohuesit nuk do të shpëtojnë.”**²³

5 - Allahu i krijoi xhinët dhe njerëzit për ta adhuruar vetëm Atë; Allahu thotë: **“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.”**²⁴

6 - Kush e adhuron Allahun me të vërtetë, do të has në lumturi dhe gëzim të madh, në jetë të mirë; Allahu thotë: **“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”**²⁵

Kuptimi i dëshmisë se Muhamedi është i dërguar i Allahut – paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të:

1 - Kuptimi i dëshmisë se Muhamedi është i dërguari i Allahut është: besimi në atë që ka lajmëruar, respektimi i asaj për të cilën ka urdhëruar, largimi nga ajo që e ka ndaluar, si dhe të mos adhurohet Allahu ndryshe përveç se me atë që Ai e ka ligjësuar.

2 - Emri i të dërguarit tonë është Muhamed, i biri i Abdullahut, i biri i Abdumutalibit, Hashimij Kureshij; dhe ai është më i miri i arabëve për nga prejardhja (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

3 - Allahu e dërgoi të dërguarin tonë Muhamedin tek të gjithë njerëzit, duke e bërë bindjen ndaj tij obligim për të gjithë njerëzit; Allahu thotë: **“Thuaj (Muhammed): “O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju.”**²⁶

4 - I dërguari ynë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka jetuar në Meke. Ai thirri në Njëshmëri dhe në adhurimin vetëm të Allahut Një; pastaj emigroi në Medine dhe urdhëroi për dispozitat tjera të islamit, sikurse zeqati, agjërimi, lufta etj. I dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) vdiç në Medine në moshën gjashtëdhjetë e tre vjeçare.

5 - Kush e kundërshton të dërguarin e Allahut meriton dënim të dhembshëm. Allahu thotë: **“Le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të dërguarit) se ata do t’i zë ndonjë telashe, ose do t’i godasë dënimi i idhët.”**²⁷

²¹ Sureja Ahzab, 41.

²² Sureja Ahkaf, 15.

²³ Sureja Mu’minun, 117.

²⁴ Sureja Dharijat, 56.

²⁵ Sureja Nahl, 97.

²⁶ Sureja Araf, 158.

²⁷ Sureja Nur, 63.

6 - Kush e respekton të dërguarin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) do të arrijë lumturi të plotë dhe fitore të madhe; Allahu thotë: **“E bindjuni Allahut dhe të dërguarit, ashtu që të mëshiroheni.”**²⁸ Poashtu thotë: **“nëse i bindeni atij, atëherë keni gjetur të vërtetën.”**²⁹

Llojet e teuhidit (njëshmërisë)

Teuhid është: ta njësosh Allahun e madhëruar me veprat e zotit, me adhurimin ndaj Tij dhe emrat dhe cilësitë e Tij të përsosura.

Llojet e teuhidit janë tri: Rububije, Uluhije dhe Esma ue Sifatë.

1. Teuhidi Rububije: është ta njësosh Allahun me veprat e Tij, sikurse: Krijimi, Furnizimi, Udhëheqja, Ngjallja, Vdekja etj.

Nuk ka krijues pos Allahut; siç thotë Allahu: **“Allahu është krijues i çdo sendi dhe Ai është mbikëqyrës ndaj çdo gjëje.”**³⁰

Nuk ka furnizues pos Allahut; siç thotë Allahu: **“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj.”**³¹

Nuk ka udhëheqës pos Allahut; siç thotë Allahu: **“Ai është që udhëheq çështjen (e të gjitha krijesave) prej qiellit në tokë.”**³²

Nuk ka kush tjetër që ngjallë e as që bën të vdesin, pos Allahut; siç thotë Allahu: **“Ai jep jetë dhe vdekje, dhe vetëm te Ai do të ktheheni.”**³³

Këtë lloj të teuhidit e kanë pranuar jobesimtarët në kohën e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe kjo nuk i ka bërë ata pjesëtarë të islamit; siç thotë Allahu: **“Nëse ti i pyet ata: “Kush krijoi qiejt e tokën?” Me siguri do të thonë: “Allahu!” Thuaj: “Allahut i qoftë lavdërimi!” Por shumica e tyre nuk dinë.”**³⁴

2. Teuhidi Uluhije është të njësohet Allahu me veprat e njerëzve me të cilat ata janë urdhëruar, si dhe të manifestohen të gjitha llojet e adhurimit ndaj Allahut që është Një, i pa rival, sikurse lutja, frika, mbështetja, kërkimi i ndihmës, kërkimi i mbrojtjes, etj.

Nuk i lutemi askujt pos Allahut, nuk i frikësohemi askujt pos Allahut, nuk i mbështetemi askujt pos Allahut, nuk kërkojmë mbrojtje nga askush pos Allahut. Allahu thotë: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ty kërkojmë ndihmë!”**³⁵

Dhe nuk kërkojmë mbrojtje pos nga Allahu; siç thotë Allahu: **“Thuaj: “Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve.”**³⁶

²⁸ Sureja Ali Imran, 132.

²⁹ Sureja Nur, 54.

³⁰ Sureja ZUmer, 62.

³¹ Sureja Hud, 6.

³² Sureja Sexhde, 5.

³³ Sureja Junus, 56.

³⁴ Sureja Lukman, 25.

³⁵ Sureja Fatiha, 5.

Ky është lloji i teuhidit me të cilin erdhën pejgamberët (alejhim esselam), siç thotë Allahu: **“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre).”³⁷**

Ky është lloji i teuhidit që e mohuan jobesimtarët me herët dhe tani, siç thotë Allahu: **“A mendon ai t’i bëjë zotat Një Zot? Vërtet, kjo është gjë shumë e çuditshme!”³⁸**

3. Teuhidi Esmau ue Sifatë është të besosh të gjithë atë që është përmendur në Kuranin Fisnik dhe në hadithet e vërteta të të dërguarit, qoftë prej emrave të Allahut dhe cilësive të Tij me të cilat e përshkroi Vetën, apo ato të cilat i dërguari ua tregoi njerëzve.

Emrat e Allahut janë të shumtë, prej tyre janë: Rrahman, Semi’ë, Basirë, Aziz, Hakim, Allahu thotë: **“Asnjë send nuk është si Ai; Ai është dëgjuesi, shikuesi.”³⁹**

Virtytet e fitimtarëve

Allahu thotë: **“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.”⁴⁰**

Allahu u betua në kohën se njeriu është në humbje, përveç nëse i ka realizuar katër gjëra:

- Imanin (besimin): E që është njohja e Allahut të madhëruar, njohja e të dërguarit dhe njohja e fesë.
- Veprën e mirë: Siç është namazi, zeqati, agjërimi, sinqeriteti dhe respektimi i prindërve.
- Qëndrimin në të vërtetën: E që është thirrja në besim (të drejtë) dhe vepër të mirë, si dhe nxitja në to.
- Këshillimi për durim: Pra durim për kryerjen e adhurimeve dhe durim gjatë fatkeqësive.

Çka e zhdukë apo e kundërshton teuhidin?

1. Allahu ua ka bërë obligim njerëzve besimin në Allahun dhe mosbesimin në djajë; siç thotë Allahu: **“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre).”⁴¹**

Kuptimi i tagutit (djajëve): çdo gjë që adhurohet pos Allahut dhe ai është i kënaqur me këtë.

³⁶ Sureja Nas, 1.

³⁷ Sureja Nahl, 36.

³⁸ Sureja Sad, 5.

³⁹ Sureja Shura, 11.

⁴⁰ Sureja Asr, 1-3.

⁴¹ Sureja Nahl, 36.

Mënyra e mosbesimit në tagut është që të besosh se adhurimi i dikujt tjetër pos Allahut është i kotë, ta urresh atë, t'i konsiderosh jobesimtarë ithtarët e tij dhe ti armiqësosh ata.

2. Shirku është e kundërta e teuhidit. Prandaj, nëse teuhid është njësimi i Allahut me adhurim, atëherë shirku është manifestimi i ndonjë adhurimi ndaj dikujt tjetër pos Allahut, lutja dikë tjetër pos Allahut, apo të bërit sexhde dikujt tjetër pos Allahut.

3. Shirku është prej mëkateve më të mëdha, mbështetur në fjalën e Allahut: **“Është e vërtetë se Allahu nuk falë (mëkatin) t'i bëhet Atij shok, e pos këtij (mëkati), të tjerat i falë atij që dëshiron.”**⁴² Shirku i prishë të gjitha adhurimet, e bën të detyrueshme qëndrimin përgjithmonë në xhehenem dhe privon nga hyrja në xhenet; siç thotë Allahu: **“Ky është udhëzim i Allahut, udhëzon me të kë të dojë nga robët e Tij. E sikur t'i përshkruajnë shok Zotit (edhe ndonjë nga këta) kishte për t'iu shkuar huq ajo që kanë vepuar.”**⁴³ Poashtu Allahu thotë: **“ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij Xhennetin dhe vendi i tij është zjarri.”**⁴⁴

4. Kufri (mosbesimi) zhduk teuhidin, ngase mosbesimi është fjalë dhe vepra të cilat e nxjerrin vepruesin e tyre nga njëshmëria dhe besimi; siç është për shembull: tallja me Allahun e madhëruar, me ajetet e Kuranit Fisnik, apo me të dërguarin; Allahu thotë: **“E nëse i pyet ti ata (përse tallen), do të thonë: “Ne vetëm jemi mahitur e dëfruar”. Thuaj: “A me Allahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni?! Mos kërkoni fare ndjesë, ju pasi që (shpallët se) besuat, keni mohuar. Nëse një grupi nga ju i falim, grupin tjetër e dënojmë, ngase ishin kriminelë.”**⁴⁵

5. Dyftytyrësia zhduk teuhidin. Dyftytyrësi është të shfaqësh para njerëzve njëshmërinë dhe besimin ndërsa të fshehësh në zemrën tënde shirkun dhe kufrin. Një shembull i dyftytyrësisë është që të shfaqësh me gojë besimin në Allahun e të fshehësh mosbesimin; siç thotë Allahu: **“Ka disa njerëz që thonë: “Ne i kemi besuar Allahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë.”**⁴⁶ Pra, me gjuhët e tyre thonë besuam në Allahun e në fakt ata nuk besojnë me zemër.

Besimi në Ditën e Fundit

Kuptimi i besimit në Ditën e Fundit është: Besim i prerë se kjo ditë do të ndodhë, prandaj secili prej nesh duhet të besojë se Allahu do t'i ringjallë njerëzit nga varret e tyre, e pastaj do t'i llogarisë e do ti shpërblejë për veprat e tyre, derisa banorët e Xhenetit të vendosen në vendet e tyre dhe banorët e Zjarrit në vendet e tyre.

Besimi në Ditën e Fundit është një prej shtyllave të besimit, dhe pa këtë nuk vlen të besuarit.

⁴² Sureja Nisa, 116.

⁴³ Sureja En Am, 88.

⁴⁴ Sureja Maide, 72.

⁴⁵ Sureja Teube, 65-66.

⁴⁶ Sureja Bekare, 8.

Besimi në Ditën e Fundit përmban disa gjëra:

1 - Besimi në ringjallje dhe tubim:

Ngjallja e të vdekurve nga varret e tyre, kthimi i shpirtave në trupat e tyre; pra kur njerëzit ngriten (ringjallen) para Zotit të botëve, pastaj dalin dhe mbledhen në një vend, këmbëzbathur dhe lakuriq, të pabërë synet. Argument për ringjalljen është fjala e Allahut: **“Mandej, pas kësaj (krijese) ju do të vdisni E në ditën e kijametit ringjalleni.”**⁴⁷

Ndërsa argument për tubimin është fjala e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Njerëzit ditën e Kiametit do të tubohen, lakuriq dhe të pabërë synet”.⁴⁸

2 - Besimi në llogarinë dhe në peshoren:

Allahu do t'i llogaritë krijesat për veprat e tyre të cilat i vepruan në jetën e kësaj bote, pastaj kush ka qenë prej ithtarëve të teuhidit dhe respektues i Allahut dhe të dërguarit të Tij, llogaria e tij do të jetë e lehtë, ndërsa kush ka qenë prej ithtarëve të kufrit dhe mëkateve, llogaria e tij do të jetë e vështirë.

Veprat do të peshohen në peshoren e madhe, me ç'rast veprat e mira do të vendohen në njërën anë dhe veprat e këqija në anën tjetër. Kujt i rëndojnë veprat e mira ndaj të këqijave ai është prej banorëve të Xhenetit, e kujt i rëndojnë të këqijat ai është prej banorëve të Zjarrit.

Argument për llogarinë është fjala e Tij: **“Sa i përket atij që i jepet libri i tij nga e djathta, ai do të llogaritet me një llogari të lehtë, dhe do të kthehet te familja e vet i gëzuar. E sa i përket atij që libri i vet i jepet pas shpinës, ai do t'i ndjellë vetes shkatërrim, dhe do të hyjë në zjarr të ndezur fort.”**⁴⁹

Argument për peshoren është fjala e Allahut: **“Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa pesha e një kokrrë të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës.”**⁵⁰

3 - Xheneti dhe Zjarri:

Xheneti është vend i kënaqësisë dhe i qëndrimit (të përhershëm), të cilin Allahu e ka përgatitur për besimtarët e devotshëm që respektuan Allahun dhe të dërguarin e Tij. Aty ka gjithfarë kënaqësish të përhershme, prej ushqimeve, pijeve, veshjeve dhe të gjitha gjërave të dashura.

Kurse Zjarri, është vend i ndëshkimit dhe i qëndrimit në të, të cilin Allahu e ka përgatitur për jobesimtarët të cilët nuk besuan Allahun dhe kundërshtuan të dërguarin e Tij, aty ka dënime, dhimbje dhe ndëshkime të llojllojshme që nuk mund të paramendohen.

⁴⁷ Sureja Mu'minun, 15-16.

⁴⁸ E transmeton Muslimi, në librin Xheneti, kapitulli Zhdukja e dunjase dhe tubimi në Ditën e Kiametit, numër 2859.

⁴⁹ Sureja Inshikak, 7-12.

⁵⁰ Sureja Enbija, 47.

Argument për Xhenetin është fjala e Allahut: **“Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për një Xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit.”**⁵¹

Poashtu fjala e Allahut: **“Pra, për ata që kanë vepruar, nuk di askush për atë kënaqësi (të zemrës e shpirtit) që u është caktuar atyre si shpërblim.”**⁵²

Ndërsa argument për Zjarrin është fjala e Allahut: **“... atëherë ruajuni zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët.”**⁵³

Poashtu fjala e Allahut: **“Se me të vërtetë te Ne ka pranga e zjarr, Edhe ushqim që nuk gëlltitet edhe dënim të dhembshëm.”**⁵⁴

O Allah ne kërkojmë prej Teje Xhenetin dhe fjalët dhe veprat që të afrojnë tek ai, dhe kërkojmë mbrojtje prej Teje nga Zjarri dhe nga fjalët dhe veprat që të afrojnë tek ai.

Parafjalë rreth akides islame dhe rëndësisë së saj

Feja islame është akide (besim, kredo) dhe sheriat (ligj). Me besim është për qëllim: gjëra të cilat i vërteton shpirti, me të cilat qetësohen zemrat dhe të cilat janë bërë bindje tek pronarët e saj, pa dyshim dhe pa hamendje.

Ndërsa me sheriat është për qëllim: vepra obligative në të cilat thërret Islami sikurse: namazi, zeqati, agjërimi, respekti i prindërve etj.

Themelet e besimit islam janë: besimi në Allahun, në melaiket, në librat, në peygamberët, në Ditën e Fundit dhe besimi në caktimin e mirë apo të keq.

Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t’i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, peygamberëve.”**⁵⁵

Dhe fjala e Allahut për caktimit (kaderin): **“Ne çdo send kemi krijuar me masë të caktuar Puna Jonë (në krijim) është e shpejtë sa çel e mshel sytë.”**⁵⁶

Dhe fjala e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): **“Iman është të besosh në Allahun, melaiket, librat, peygamberët, ditën e Fundit dhe të besosh në caktimin e tij të mirë apo të keq.”**⁵⁷

⁵¹ Sureja Ali Imran, 133.

⁵² Sureja Sexhde, 17.

⁵³ Sureja Bekare, 24

⁵⁴ Sureja Muzemil, 12-13.

⁵⁵ Sureja Bekare, 177.

⁵⁶ Sureja Kamer, 49-50.

⁵⁷ E transmeton Muslimi në kapitullin e Imanit, numër 8.

Rëndësia e besimit Islam

Besimi Islam shfaqet nëpërmjet shumë çështjeve, prej tyre:

1 - Nevoja jonë për këtë besim është, mbi të gjitha, kërkesë e domosdoshme, sipër çdo domosdoshmërie, ngase nuk ka lumturi, e as kënaqësi e gëzim për zemrat pos duke adhuruar Zotin që i ka krijuar.

2 - Besimi islam është prej obligimeve më të mëdha dhe më të rëndësishme; për këtë arsye ai është gjëja e parë që kërkohet nga njerëzit; ashtu siç ka thënë i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij.”⁵⁸

3 - Besimi islam është besimi i vetëm përmes së cilit realizohet siguria, përqendrimi, gëzimi e hareja; Allahu thotë: **“Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që i është dorëzuar Allahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten.”**⁵⁹

Ashtu siç besimi islam është i vetmi që realizon rehatinë dhe shëndoshmërinë, sikurse thotë Allahu: **“E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t’ju hapnim begati nga qielli e toka.”**⁶⁰

4 - Besimi islam është shkak për arritjen e sundimit në tokë, dhe ngritjen e shtetit islam, Allahu thotë: **“Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Lehvi Mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robtë e Mi të mirë.”**⁶¹

Besimi në Allahun e Madhëruar dhe Fisnik

Kuptimi i besimit në Allahun është: Besimi i prerë në ekzistimin e Allahut të Madhëruar, pranimi i njëshmërisë së Tij, si dhe realizimi i njësimi të Tij përmes veprave të robërve dhe përmes Emrave dhe Cilësive të Tij.

Imani në Allahun përfshin katër gjëra:

1 - Besimi në ekzistimin e Allahut.

2 - Besimi në njëshmërinë e Tij.

3 - Besimi në njëshmërinë uluhije.

4 - Besimi në Emrat dhe cilësitë e Allahut.

Për këto katër pika do të flasim detajisht në vazhdim:

⁵⁸ E transmeton Buhariu, libri i Imanit, numër 25.

⁵⁹ Sureja Bekare, 112.

⁶⁰ Sureja Araf, 96.

⁶¹ Sureja Enbija, 105.

1 - Besimi në ekzistimin e Allahut

a) Pohimi i ekzistimit të Allahut të Madhëruar është çështje antropologjike, shumica e njerëzve pohojnë ekzistimin e Allahut, dhe këtë nuk e kundërshton kush pos një pakice, siç janë ateistët.

Çdo krijesë ka zhvilluar besimin në Krijuesin e tij pa pasur nevojë për dituri të mëparshme, ndërsa ajo që dëgjojmë dhe shohim sot nga përgjigjet e thirrësve dhe nga pyetjet e pyetësve aludon bindshëm në ekzistimin e Allahut të Madhëruar; siç thotë Allahu: **“Përkujtoni kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj, e Ai u është përgjigjur.”**⁶²

b) Është e ditur për çdo njeri se çdo për çdo shpikje patjetër ka një shpikës, prandaj edhe këto krijesa të shumta të cilat i shohim vazhdimisht patjetër duhet ta kenë një Krijues, e ai është Allahu; Ngase është pamundshme që krijesat të ekzistojnë pa krijues, ashtu siç është e pamundshme që njeriu të krijojë vetveten, ngase nuk asgjë nuk mund të krijohet vetvetiu; Allahu i lartmadhëruar thotë: **“A mos u krijuan prej kurrigjësë, apo ata vetë janë krijues?”**⁶³

Kuptimi i ajetit është se: Ata nuk u krijuan pa krijues, e as e krijuan vetveten; prandaj vijmë në përfundim se krijuesi i tyre është Allahu i Madhëruar.

c) Sistemi i universit me qiejt, tokën, yjet dhe drunjët aludojnë në mënyrë të pakundërshtueshme se ky univers ka Një Krijues të Vetëm, i cili është Allahu i Lartmadhëruar: **“mjeshteri i Allahut që përsosi çdo send.”**⁶⁴

Planetet dhe yjet për shembull, udhëtojnë në sistem të palëvizshëm duke mos dalur prej rregullit, çdo planet udhëton në hapsirën që nuk e tejkalon; Allahu thotë: **“As dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata paraditën por secili noton në një galaktikë.”**⁶⁵

2 - Besimi në njëshmërinë e Allahut (rububije)

a) Kuptimi i besimit në njëshmërinë e Allahut është: pohimi se Allahu i Madhëruar është Zoti i gjithësisë, Sunduesi, Krijuesi, Furnizuesi, është Ai që ngjall dhe që sjell vdekjen, është dobiprurësi dhe përcaktuesi i dëmit, Atij i takojnë të gjitha çështjet, në dorën e Tij është mirësia, Ai është i fuqishëm për çdo gjë dhe nuk ka ndonjë rival.

Besimi në rububije është besimi i prerë se Allahu i Lartmadhëruar është Zot që nuk ka rival, njësimi i Allahut në veprat e Tij, besimi se Allahu është Një, Krijues i çdo gjëje në gjithësi; sikur që Allahu thotë: **“Allahu është krijuesi i çdo gjëje.”**⁶⁶

Ai është Furnizuesi i gjithë krijesave; ashtu siç thotë Allahu: **“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj.”**⁶⁷

⁶² Sureja Enfal, 9.

⁶³ Sureja Tur, 35.

⁶⁴ Sureja Neml, 88.

⁶⁵ Sureja Jasin, 40.

⁶⁶ Sureja Zumer, 62.

⁶⁷ Sureja Hud, 6.

Ai është Sunduesi i çdo gjëje: **“Vetëm i Allahut është sundimi ndaj qiejve e tokës dhe çka ka në to.”**⁶⁸

b) Allahu ka detyruar për gjithë njerëzit të jetë njëshmëria e tij në rububije , Allahu thotë: **“Falënderimi i takon Allahut Zotit të botëve.”**⁶⁹

Kuptimi i fjalës **“Zotit të botëve”** është se Ai i ka krijuar, i ka sunduar, ai u sjell dobi, ai i mbikëqyrë me begatinë dhe dëshirën e Tij.

c) Allahu ka krijuar krijesat me besim në rububijetin, saqë edhe mushrikët arabë në kohën e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), siç na tregoi Allahu: **“Thuaj: “Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zot i Arshit të madh?” Ata do të thonë: “Allahu!”. Thuaju: “E pse nuk frikësoheni pra?” Thuaj: “Në dorën e kujt është i tërë pushteti i çdo sendi, dhe Ai është që mbron (kë të do), e që prej Atij nuk mund të ketë të mbrojtur; nëse jeni që e dini?” Ata do të thonë: “Në dorë të Allahut!” Thuaj: “E si mashtroheni pra?”**⁷⁰

Besimi në rububije nuk i mjafton njeriut të hyn në islam, por duhet patjetër të beson në uluhije, ngase i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i ka luftuar mushrikët edhe pse pohonin njëshmërinë e rububijes në Allahun e madhëruar.

d) Gjithësia, me qiejt e tokën, planetet dhe yjet, drunjtë, njerëzit dhe xhinët, të gjithë i janë nënshtruar Allahut; Allahu thotë: **“E Atij i është dorëzuar gjithë çka ka në qiej e në tokë, me dashje e pa dashje dhe tek Ai kthehen.”**⁷¹

Asnjë nga krijesat nuk ekziston jashtë caktimit të Allahut, sepse Allahu është Sunduesi i tyre, udhëheqë ashtu si do Ai, sipas urtësisë së Tij, Ai është krijuesi i të gjithë atyre, dhe çdo gjë pos Allahut është e krijuar, e varfër, e nevojshme për Krijuesin e saj të Madhëruar.

e) Prandaj, pasi që arritëm në përfundimin se Allahut i takojnë të gjitha çështjet, pra nuk ka krijues pos Allahut, as furnizues pos Allahut, as udhëheqës të gjithësisë pos Allahut Një, dhe se asnjë kokërr nuk lëviz pa lejen e Tij, atëherë kjo obligon lidhjen e zemrave tona me Allahun – të Vetmin, lutjen e Tij, ndjenjën e nevojës për Të, mbështetjen tek Ai, ngase Ai është i Lartësuar, Krijuesi jonë, Furnizuesi dhe Sunduesi.

3 – Besimi në njëshmërinë e Allahut (uluhije)

a) Kuptimi i besimit në uluhije është: të besosh në mënyrë të prerë se Allahu i Madhëruar është i vetmi që meriton të gjitha llojet e adhurimeve, të dukshmet apo të fshehtat, siç janë: lutjet, frika, mbështetja, kërkimi i ndihmës, namazi, zeqati, agjërimi; duke e kuptuar mirë se vetëm Allahu duhet të adhurohet dhe Ai nuk ka shok, dhe se nuk ta të adhuruar tjetër pos Allahut; ashtu siç thotë Allahu: **“Zoti juaj (që meriton adhurim) është Një, Allahu, nuk ka zot pos Atij që është mëshirëplotë, gjithnjë mëshiron.”**⁷²

⁶⁸ Sureja Maide, 120.

⁶⁹ Sureja Fatiha, 4.

⁷⁰ Sureja Muminun, 86-89.

⁷¹ Sureja Ali Imran, 83.

⁷² Sureja Bekare, 163.

Allahu i madhëruar na ka treguar se ekziston vetëm Një i adhuruar, dhe nuk lejohet të merret për Zot dikush tjetër, e as të adhurohet dikush pos Tij.

b) Besimi në njëshmërinë e Allahut (uluhije) është: Pranimi se Allahu është Një, Zoti i vërtetë, i pa rival; fjala Zot nënkupton hyjni, një të adhuruar me dashuri dhe madhërim; prandaj, kjo është njëshmëria e Allahut me të gjitha adhurimet, nuk i lutemi askujt pos Allahut, nuk i frikësohemi askujt pos Allahut, nuk i mbështetemi askujt pos Allahut, nuk i bëjmë sexhde askujt pos Allahut, nuk i nënshtrohemi askujt pos Allahut, pra nuk meriton adhurim askush pos Tij, të Lartësuarit; e kjo pra është realizim i fjalës së Allahut: **“Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”**⁷³

c) Rëndësia e besimit në njëshmërinë uluhije të Allahut:

1 – Qëllimi i krijimit të xhinëve dhe njerëzve është adhurimi i Allahut Një, i Cili nuk ka rival; prandaj Allahu thotë: **“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.”**⁷⁴

2 – Qëllimi i dërgimit të pejgambereve dhe zbritjes së librave nga qielli është pohimi se Allahu është i Vetmi i adhuruar me meritë; ashtu siç thotë Allahu: **“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre).”**⁷⁵

3 – Obligimi i parë për çdo person është besimi në uluhijetin e Allahut, ashtu siç është përmendur në porosinë e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) Muadh ibn Xhebelit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), kur e dërgoi në Jemen, duke i thënë: “Ti po shkon tek një popull që janë ithtarë të librit, le të jetë gjëja e parë në të cilën do t’i thërrasësh dëshmia se nuk ka Zot tjetër pos Allahut.”⁷⁶

Pra thirri ata që të adhurojnë vetëm Allahun Një, në të gjitha adhurimet e tyre.

d) Kuptimi i dëshmisë “La ilahe il Allah” (Nuk ka Zot tjetër pos Allahut):

Kjo fjalë madhështore është obligimi i parë i çdo personi, ashtu siç është edhe obligimi i fundit, ngase kush vdes me këtë fjalë ai është prej banorëve të Xhenetit; siç ka thënë i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Kush vdes, duke qenë në dijeni se nuk ka Zot tjetër pos Allahut, do të hyjë në Xhenet.”⁷⁷

Për atë, obligueshmëria e kuptimit të dëshmisë “La ilahe il Allah” është prej punëve dhe detyrave më të mëdha.

“La ilahe il Allah” do të thotë: Nuk meriton të adhurohet askush pos Allahut Një; duke shprehur kështu mohim të çdo hyjnie tjetër pos Allahut, dhe konfirmimin e adhurimit të plotë vetëm për Allahun, të Vetmin. i Cili nuk ka rival.

⁷³ Sureja Fatiha, 5.

⁷⁴ Ureja Dharijat, 56.

⁷⁵ Sureja Nahl, 36.

⁷⁶ E transmeton Muslimi, libri i Besimit, numër 19.

⁷⁷ E transmeton Muslimi, libri i Besimit, numër 26.

Kuptimi i fjalës Zot është: I adhuruar; prandaj, kush adhuron diçka kjo nënkupton se e ka marrë atë për për zot në vend të Allahut, ndërsa të gjitha ato janë të kota përveç Zotit të Vetëm, e që është Allahu.

Allahu i madhëruar është Zoti të Cilin e adhurojnë zemrat me dashuri, e respektojnë dhe e madhërojnë, i përulen Atij, i nënshtrohen, i frikësohen, i mbështeten dhe i luten vetëm Atij.

Zemrat nuk kanë gëzim e as lumturi pos duke realizuar kuptimin e fjalës “la ilahe il Allah,” ngase gëzimi i plotë, jeta e mirë dhe e kënaqshme realizohet vetëm përmes njësimit të Allahut të Madhëruar me adhurim.

e) Kushtet e fjalës “la ilahe il Allah”:

Kjo fjalë madhështore ka dy shtylla: Pohimin dhe mohimin.

Shtylla e parë “La ilahe” – nuk ka Zot tjetër – është mohim i adhurimit të dikujt tjetër pos Allahut, shkatërrim i shirkut dhe obligim për mosbesim ndaj çdo gjëje tjetër që adhurohet pos Allahut.

Shtylla e dytë: “il-lAllah” – pos Allahut – është pohim i adhurimit ndaj Allahut Një, njësimit të Tij me të gjitha llojet e adhurimit; argument për këtë është: **“E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë.”**⁷⁸ Fjala e Allahut këtu: **“E kush nuk i beson të pavërtetat,”** është kuptimi i shtyllës së parë “La ilahe”, ndërsa fjala e Tij **“e i beson Allahut,”** është kuptimi i shtyllës së dytë “il-lAllah”.

Dëshmia “La ilahe il Allah” medoemos duhet të ketë shtatë kushte pa të cilat nuk i bën dobi thënësit të saj; e ato janë:

1 – **Dituria** mbi fjalën “La ilahe il Allah;” siç është thënë në fjalën e Allahut: **“Atëherë, dije se nuk ka zot tjetër pos Allahut, kërko falje për mëkatin tënd.”**⁷⁹

2 – **Bindja**: Ai që e shpreh këtë fjalë duhet të jetë i bindur në konceptet e saja, e nëse është i dyshimtë në aludimet e saj atëherë nuk i bën dobi, sepse Allahu thotë: **“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut, të dërguarit e Tij, e mandej nuk dyshuan.”**⁸⁰

3 – **Pranimi** i gjithë asaj në të cilën thërret kjo fjalë, siç është adhurimi i Allahut Një, largimi nga adhurimi i dikujt tjetër pos Tij. Pra, kush e thotë atë duke mos pranuar adhurimin e diçkaje tjetër përveç Allahut, ai është prej atyre për të cilët Allahu tha: **“... Për arsye se kur u thuhej atyre: “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, ata e mbanin veten lart. Dhe thoshin: “A do t’i braktisim ne zotat tanë për një poet të çmendur?.”**⁸¹

4 – **Nënshtimi** ndaj kësaj fjale; Allahu thotë: **“E kush ia dorëzon veten Allahut duke qenë edhe punëmirë, ai është kapur për lidhjen më të sigurt.”**⁸²

⁷⁸ Sureja Bekare, 256.

⁷⁹ Sureja Muhamed, 19.

⁸⁰ Sureja Huxhurat, 15.

⁸¹ Sureja Safat, 35-36.

⁸² Sureja Llukman, 22.

Kuptimi i fjalës “kush ia dorëzon veten,” pra i nënshtrohet dhe i dorëzohet, ndërsa “lidhjen më të sigurt” është dëshmia “La ilahe il Allah.”

5 – **Vërtetësia** - është ta shprehësh këtë fjalë nga zemra me vërtetësi; siç ka thënë i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Kushdo që dëshmon se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, me vërtetësi nga zemra e tij, Allahu do ta bën haram zjarrin për te.”⁸³

6 – **Sinqeriteti** - nënkupton pastrimin e veprës nga çdo ngjyrim shirku, e duke mos pasur me këtë fjalë qëllim tjetër apo kënaqësi prej kënaqësive të dunjasë; Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Allahu ia ka ndaluar Zjarrin atij që thotë La ilahe il Allah, duke shpresuar me të fytyrën e Allahut.”⁸⁴

7 – **Dashuria** ndaj kësaj fjale, ndaj detyrimeve që dalin nga kjo fjalë, dhe ndaj ithtarëve të kësaj fjale; Allahu thotë: **“E nga njerëzit ka sosh që në vend të Allahut besojnë idhujt, që i duan (i madhërojnë) ata, sikur (që besimtarët e vërtetë e duan) Allahun, po dashuria e atyre që besuan Allahun është shumë më e fortë.”**⁸⁵

Ithtarët e fjalës “La ilahe il Allah” e duan Allahun me dashuri të singertë, kurse ithtarët e shirkut i bëjnë shirk, dhe duan me Allahun edhe dikë tjetër nga të adhuruar tjerë, e kjo gjë e mohon kuptimin e fjalës “La ilahe il Allah.”

f) Kuptimi i adhurimit:

Fjala “adhurim” është emër i përgjithshëm për çdo gjë që Allahu e do dhe është i kënaqur me të, nga fjalët dhe veprat e brendshme dhe të jashtme, sikurse janë dashuria ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), frika ndaj Allahut, mbështetja në Allahun, lutja, namazi, zeqati, respekti ndaj prindërve, përmendja e Allahut, xhihadi ndaj jobesimtarëve dhe dyfytërësive, etj.

Pra, adhurimet janë të shumta, dhe këtu janë për qëllim të gjitha llojet, sikurse leximi i Kuranit Fisnik, bamirësia ndaj të varfërve dhe nevojtarëve, vërtetësia, amaneti dhe fjala e mirë.

Adhurimi përthekon të gjitha lëvizjet e besimtarit, nëse është prej atyre që kanë për synim të vetëm afrimin tek Allahu, e bile dhe nëse ndokush prej nesh han, pin apo bën gjumë me qëllim për tu forcuar në adhurim ndaj Allahut, ai shpërblehet për këtë; këto zakone të përditshme të njeriut me synim të mirë dhe të vërtetë shndërrohen në adhurime për të cilat shpërblehet, ngase adhurimi nuk është i përkufizuar në ritet e njohura sikurse namazi, agjërimi etj.

g) Adhurimi është ajo për të cilën Allahu i krijoi krijesat e Tij:

⁸³ E transmeton Buhariu, libri Dituria, 128.

⁸⁴ E transmeton Buhariu, libri Vlera e namazit në xhaminë e Mekes dhe Medines, 1185.

⁸⁵ Sureja Bekare, 165.

Allahu thotë: **“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as s’dëshiroj të më ushqejnë ata. Allahu është furnizues i madh. Ai, fuqiforti.”**⁸⁶

Allahu na ka treguar se urtësia e krijimit të xhinëve dhe njerëzve është që ata të adhurojnë Allahun, ndërsa Allahu është i panevojë për adhurimin e tyre por ata janë nevojtarë që ta adhurojnë Allahun.

Nevoja e njeriut për Allahun e Madhëruar, për ta adhuruar Allahun dhe për të mos i bërë shirk atij në asgjë, është më e madhe se nevoja për ujë dhe ushqim.

Nëse zemra e shijon ëmbëlsinë e adhurimit të Allahut dhe ëmbëlsinë e singëritetit, për të nuk do të ketë diç më të ëmbël, më të shijshme e më të mirë se kjo; siç edhe nuk mund të pushojë nga dhimbjet dhe problemet e dunjasë përveç se duke praktikuar adhurimin ndaj Allahut të Madhëruar.

j) Shtyllat e adhurimit:

Adhurimi me të cilin na ka urdhëruar Allahu është i ngritur në dy shtylla kryesore:

Një: Nënshtrimi dhe frika absolute.

Dy: Dashuria absolute.

Pra, adhurimi me të cilin na ka obliguar Allahu duhet të përmbajë në vete nënshtrim absolut ndaj Allahut, dorëzim dhe frikë ndaj Tij, me dashuri absolute, adhurim dhe shpresim.

Dashuria nuk përmban në veten e saj frikë e as nënshtrim, prandaj dashuria ndaj pasurisë dhe ushqimit nuk është adhurim, poashtu edhe frika pa dashuri, siç është frika nga kafshët e egra nuk llogaritet adhurim; por nëse frika dhe dashuria bashkohen në një vepër të vetme atëherë ajo quhet adhurim; e ky adhurim nuk i takon dikujt tjetër pos Allahut të Madhëruar.

k) Teuhidi është shkak për pranimin e adhurimit:

Adhurimi të cilin e urdhëroi Allahu nuk konsiderohet adhurim pos nëse shoqërohet me teuhid (njësim) ndaj Allahut të Madhëruar; pra, adhurimi nuk është i vlefshëm nëse shoqërohet me shirk, e as nuk mund të cilësohet dikush si rob i Allahut pos duke realizuar teuhidin dhe njësimin e Allahut me adhurim, pra kush e adhuron Allahun dhe i bën shirk me dikë tjetër ai nuk është rob i Allahut.

Teuhidi ndaj Allahut, adhurimi i singërtë dhe mos-veprimi i shirkut, janë kushte për pranimin e adhurimit tek Allahu; për më tepër, adhurimi nuk është i pranuar pos duke qenë i pajtuar plotësisht me ligjin e Allahut dhe me sunetin e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

⁸⁶ Sureja Dharijat, 56-58.

Pra, kusht i pranimit të çdo vepre tek Allahu është:

1 – Të mos adhurosh kë pos Allahut Një (që është kuptimi i teuhidit)

2 – Të mos veprosh tjetër pos atë që Allahu e ka urdhëruar (e që është pasimi i të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)); siç thotë Allahu: “... **po ai që i është dorëzuar Allahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërzhiten.**”⁸⁷

Kuptimi i fjalës “që i është dorëzuar” nënkupton se e ka realizuar teuhidin, dhe sinjerisht e ka adhuruar Allahun. Ndërsa kuptimi i fjalës “dhe është bamirës” nënkupton se është pasues i të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

l) Shirku:

Shirku e kundërshton besimin në uluhije. Nëse besimi në uluhije ndaj Allahut Një, dhe njësimi i Allahut me adhurim, janë prej obligimeve më të rëndësishme dhe më madhështore, atëherë edhe shirku është mëkati më i madh tek Allahu i Madhëruar, duke qenë se është mëkati i vetëm të cilin Allahu nuk e falë asses; Prandaj, Allahu thotë: “**Eshtë e vërtetë se Allahu nuk falë (mëkatin) t’i bëhet Atij shok, e pos këtij (mëkati), të tjerat i falë atij që dëshiron.**”⁸⁸

Kur i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u pyet për mëkatin më të madh tek Allahu, tha: “Ti shoqërosh Allahut shok e Ai të ka krijuar.”⁸⁹

Shirku i shkatërron e i asgjëson adhurimet; siç thotë Allahu: “**E sikur t’i përshkruajnë shok Zotit (edhe ndonjë nga këta) kishte për t’iu shkuar huq ajo që kanë vepuar.**”⁹⁰

Shirku e bën obligim të qëndruarit e përhershëm në Zjarr për ithtarit e tij. Allahu thotë: “... **ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij Xhennetin dhe vendi i tij është zjarri.**”⁹¹

Shirku është dy llojesh: I madh dhe i vogël.

Shirk i madh është: kur njeriu ia drejton ndonjë prej adhurimeve të tij dikujt tjetër pos Allahut. Prandaj, çdo fjalë apo vepër që e do Allahu, veprimi i saj për Allahun është teuhid ndërsa besimi dhe veprimi i saj për dikë tjetër është shirk dhe mosbesim.

Si për shembull: t’i lutet dikujt tjetër pos Allahut për furnizim apo shëndet, apo t’i mbështetet dikujt tjetër pos Allahut apo t’i bëjë sexhde; ndërsa Allahu thotë: “**Zoti juaj ka thënë: “Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem.”**”⁹²

⁸⁷ Sureja Bekare, 112.

⁸⁸ Sureja Nisa, 116.

⁸⁹ E transmeton Buhariu në librin e dëmshtëpërblimeve, kaptina mbi fjalën e Allahut “Kush vret qëlimisht një besimtarë shpërblimi i tij është xhehenemi” me numër 6861.

⁹⁰ Sureja Enam, 88.

⁹¹ Sureja Maide, 72.

⁹² Sureja Gafir, 60.

“Dhe vetëm Allahut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë të singertë.”⁹³

“Pra, bini në sexhde për Allahun dhe adhurojeni.”⁹⁴

Pra, nëse lutja, mbështetja dhe sexhdja janë prej adhurimeve të cilat Allahu i urdhëroi, atëherë kush ia drejton këto Allahut, ai është monoteist dhe besimtar, e kush ia drejton këto dikujt tjetër pos Allahut, ai është politeist jobesimtar.

Shirk i vogël është çdo thënje apo vepër që të shpie deri te shirku i madh, apo çdo rrugë përmes së cilës bie në shirk.

Si për shembull: marrja e varreve për xhami, falja pranë varreve, apo ndërtimi i xhamisë mbi ndonjë varr; të gjitha këto janë të ndaluara, dhe personi i tillë është i mallkuar, i refuzuar dhe i larguar nga mëshira e Allahut; duke u mbështetur për këtë në fjalën e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Mallkimi i Allahut qoftë mbi jehudët dhe të krishterët, i morrin varret e pejgambereve të tyre për xhamia.”⁹⁵

Pra, marrja e varreve për vend falje - xhami është e ndaluar, nuk lejohet; njëherit është edhe mjet që dërgon tek lutja e të vdekurve, ndërsa lutja e të vdekurve është shirk i madh.

4 - Besimi në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

a) Nënkupton vërtetimin e asaj që Allahu e ka konfirmuar për veten e tij në Kuran apo në sunetin e të dërguarit të Tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) për emrat dhe cilësitë, sipas mënyrës që i takon Allahut të Madhëruar.

Nuk ka asgjë si Ai, në emrat dhe cilësitë e Tij; ashtu siç thotë Allahu: **“Ai është krijues i qiejve dhe i tokës. Ai nga lloji juaj krijoi për ju bashkëshorte, edhe nga kafshët krijoi çifte, ashtu që t’ju shumojë. Asnjë send nuk është si Ai; Ai është dëgjuesi, shikuesi.”⁹⁶**

Sa u përket Emrave dhe Cilësive të Tij, Allahu i Madhëruar është i pastër nga çdo përngjasim me ndonjë krijesë. Emrat e Allahut janë të shumtë, prej tyre janë: Rrahman (Mëshiruesi), Besir (Shikuesi), Aziz (i Fuqishëm), Allahu thotë: **“Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.”⁹⁷**

“Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.”⁹⁸

“Ai është i Gjithëfuqishmi, i Urti.”⁹⁹

b) Frytet e besimit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut:

⁹³ Sureja Maide, 23.

⁹⁴ Sureja Nexhm, 62.

⁹⁵ E transmeton Muslimi në librin Xhamitë, kapitulli mbi ndalimi I ndërtimit të xhamive mbi varre me numër 531.

⁹⁶ Sureja Shura, 11.

⁹⁷ Sureja Fatiha, 3.

⁹⁸ Sureja Shura, 11.

⁹⁹ Sureja Lukman, 9.

1 - Njohja e Allahut të Madhëruar; kush i beson Emrat dhe Cilësitë e Allahut e njeh Allahun, dhe për më tepër i shtohet besimi i bindshëm në Allahun e Lartësuar dhe i forcohet njëshmëria e tij ndaj Allahut.

2 - Falënderimi i Allahut me Emrat dhe Cilësitë e Tij, gjë që është prej gjërave më të preferuara; Allahu thotë: **“O ju që besuat, përkujtoni Allahun sa më shpesh.”**¹⁰⁰

3 - Kërkimi dhe lutja e Allahut me Emrat dhe Cilësitë e Tij; Allahu thotë: **“Allahu ka emrat më të mirë, andaj Atë thirrreni me ata.”**¹⁰¹

Si për shembull të thuash: “O Allah unë kërkoj prej Teje, se Ti je Furnizuesi, më furnizo! ...”

4 - Lumturi dhe jetë të mirë në dynja, si dhe kënaqësinë e Xhenetit në botën tjetër.

Ndikimi i besimit në Allahun e Madhëruar

Besimi në Allah ka efekte pozitive si në dynja ashtu edhe në ahiret, ngase mirësitë e dynjasë dhe ahiretit dhe largimi i të këqijave është gjurmë e imanit, ndërsa prej gjurmëve të imanit janë:

1 - I largon të gjitha të këqijat nga besimtari, e shpëton atë prej vështirësive, e ruan nga dredhitë e armiqve; Allahu thotë: **“Allahu largon dëmet e idhujtarëve ndaj atyre që besuan.”**¹⁰²

2 - Besimi është shkak për një jetë të mirë dhe të lumtur, Allahu thotë: **“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë).”**¹⁰³

3 - Besimi e pastron shpirtin nga devijimet, prandaj kush i beson Allahut me të vërtetë, ai i ndërlidhë çështjet e tij vetëm me Allahun e Madhëruar, ngase Ai është Zot i botëve, është Zoti i vetëm përveç të Cilit s’ka zot tjetër; prandaj ky person nuk i frikësohet ndonjë krijese, e as që e lidh zemrën e tij me njerëzit, duke u liruar kështu nga devijimet dhe dyshimet.

4 - Shpëtim, arritje e çdo kërkesë (nevoje), mirëqenie prej tmerrit; ashtu siç thotë Allahu: **“Të tillët janë të udhëzuar nga Zoti i tyre dhe vetëm ata janë të shpëtuarit.”**¹⁰⁴

5 - Efekti më i madh i besimit është arritja e kënaqësisë së Allahut, hyrja në Xhenet, dhe shpëtimi, për të arritur kështu kënaqësi të përhershme dhe mëshirën absolute.

¹⁰⁰ Sureja Ahzab, 41.

¹⁰¹ Sureja Araf, 180.

¹⁰² Sureja Haxh, 38.

¹⁰³ Sureja Nahl, 97.

¹⁰⁴ Sureja Bekare, 5.

Besimi në melaqet

a) Kuptimi i besimit në melaqe

Është besimi i prerë në ekzistimin e melaqeve dhe se ato janë krijesa të Allahut, nuk e kundërshtojnë Atë në atë që i urdhëron dhe i zbatojnë urdhrat e Tij; Allahu thotë: **“ata janë robër të ndershëm! Që nuk flasin para Tij, ata veprojnë me urdhrin e Tij.”**¹⁰⁵

Besimi në melaqet ngërthen në vete katër gjëra:

1 - Besimi në ekzistimin e tyre.

2 - Besimi në emrat që janë të njohur, si Xhibrili (alejhi salam), ndërsa sa u përket emrave që nuk i dimë, e kemi obligim të besojmë në ta në mënyrë të përgjithshme.

3 - Besimi në fizionominë e tyre, siç na është përshkruar.

4 - Besimi në veprat që ato i kryejnë me urdhrin e Allahut - adhurimi i Allahut natën e ditën pa lodhje e lëshime.

Besimi në melaqet është një prej shtyllave të imanit; Allahu thotë: **“I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij.”**¹⁰⁶

Gjithashtu i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë për imanin se është: **“Të besosh Allahun, melaqet, librat, të dërguarit, Ditën e Fundit dhe të besosh në caktimin e Tij, qoftë i mirë apo i keq”.**¹⁰⁷

b) Cilësitë e melaqeve:

Prej cilësive qenësore të melaqeve është ajo që ka përmendur i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) se ato janë krijuar nga drita; i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: **“Melaqet janë krijuar nga drita”.**¹⁰⁸

Ndërsa Allahu i Madhëruar ka treguar se melaqet kanë krahë, dhe numri i krahëve të tyre dallon; dhe ka thënë: **“Falënderimi i qoftë Allahut, Krijuesit të qiejve e tokës, Sajuesit të engjëjve me nga dy palë, tri palë e katër palë krahë, ndërmjetësues (midis Tij dhe pejgamberëve). Ai shton në krijim atë që do, vërtet Allahu ka fuqi për çdo send”.**¹⁰⁹

I dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) kishte parë Xhibrilin (alejhi salam) i cili kishte gjashtëqind krahë.¹¹⁰ Pastaj melaqja ka mundësi të shndërrohet, me fuqinë e Allahut, në formë njeriu, sikur që ka ndodhur me Xhibrilin (alejhi salam) kur Allahu e kishte dërguar tek Merjemja në formë njeriu; e poashtu edhe melaqet që Allahu i kishte dërguar tek Ibrahim dhe Luti (alejhima salam), ishin në formë të njeriut.

¹⁰⁵ Sureja Enbija, 26-27.

¹⁰⁶ Sureja Bekare, 285.

¹⁰⁷ E transmeton Muslimi, numër 8.

¹⁰⁸ Transmeton Muslimi, me numër 2996.

¹⁰⁹ Sureja Fatir, 1.

¹¹⁰ Transmeton Muslimi me numër 174.

Melaqet, me të vërtetë janë një botë e fshehtë, janë krijesa që adhurojnë Allahun e Madhëruar e të cilat nuk kanë aspak cilësi hyjnore, por janë robër të Allahut, plotësisht të përkushtuar në respekt ndaj Allahut; siç ka thënë Allahu (subhanehu ve teala) për to: **“nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar”**.¹¹¹

c) Llojet e melaqeve dhe veprat e tyre:

Melaqet kanë detyra të cilat i kryejnë në këtë botë, dhe ato janë disa llojesh; ja disa prej tyre:

1 - I autorizuari që ta përcjellë shpalljen nga Allahu i Madhëruar tek të dërguarit (alejhim selam); e ky është Xhibrili (alejhi selam).

2 - I autorizuari që të menaxhojë me shiun.

3 - I autorizuari për fryrjen e Surit¹¹²; e ai është Israfil (alejhi selam).

4 - I autorizuari për marrjen e shpirtave; e ajo është melaqja e vdekjes dhe ndihmësit e saj.

5 - I autorizuari për regjistrimin, ruajtjen e veprave të robit, qoftë vepër e mirë apo e keqe; dhe ato janë të ashtuquajturat Shkruesit e ndershëm (Kiramun Katibinë).

Prej tyre janë: rojtarët e Xhenetit, rojtarët e Xhehenemit; prej tyre ka melaqe që janë në kërkim të ndejave (mexhliseve) të mira ku përmendet Allahu; pastaj meleku i autorizuar për malet; melaqet e rreshtuar të cilët nuk shpifin, të cilët qëndrojnë në këmbë për Allahun pa ndjerë lodhje. Prandaj, ushtrinë e Zotit nuk e di askush pos tij; i Lartësuar qoftë nga çdo e metë!

d) Efektet e besimit në melaqe:

Besimi në melaqe lë gjurmë të mëdha në jetën e besimtarit, prej tyre do të përmendim:

1 - Dituria për madhështinë e Allahut, fuqinë dhe mundësinë e tij absolute, dhe se madhështia e krijesës është tregues për mashështinë e Krijuesit, prandaj, besimtarit i shtohet respekti dhe madhërimi ndaj Tij kur e kupton se Allahu i Madhëruar krijoi melaqe me flatra, prej dritës.

2 - Përqendrimi në adhurim të Allahut. Kush beson se melaqet i regjistrojnë të gjitha veprat e tij, kjo sjell si fryt frikën nga Allahu i Madhëruar, prandaj ai nuk mëkaton, as haptas e as fshehtas.

3 - Durimi në adhurim ndaj Allahut, ndjenja e butësisë, qetësisë kur besimtari bindet se me vete, në këtë gjithësi të gjerë, ka mijëra melaqe që adhurojnë Allahun në formën më të bukur dhe më të përsosur.

¹¹¹ Sureja Tahrim, 6.

¹¹² Sur, është lloj briri në të cilin ryhet.

4 - Falënderimi i Allahut të Madhëruar për kujdesin e Tij ndaj pasardhësve të Ademit; saqë bëri për njeriun melekë që do ta ruajnë e mbrojnë.

5 - Të sjellit ndërmend se kjo botë është e përkohshme, dhe nuk do bëhet e përhershme asnjëherë, kur kujton melekun e vdekjes i cili është urdhëruar për t'i marrë shpirtin, pasi që Allahu ka vendosur që të vdesë, kështu që ai prej këtij momenti kujdeset për t'u përgatitur për ditën e Fundit me besim dhe vepër të mirë.

Besimi në librat

a) Domethënia e besimit në libra:

Besimi i prerë në vërtetësinë se Allahu i Madhëruar ka libra që ua ka zbritur njerëzve përmes pejgamberëve, dhe se këto libra janë fjalë të Allahut me të cilat ka folur në kuptimin konkret ashtu siç i takon Atij, i Lartësuar nga çdo e metë qoftë, dhe se në këto libra është e vërteta, drita dhe udhëzimi për njerëzit në të dy botët.

Besimi në libra përfshin tri gjëra:

Një: Besimi se Allahu i ka zbritur të gjitha.

Dy: Besimi në emrat me të cilët Allahu i emërtoi këto libra, siç janë: Kurani Fisnik, i cili i zbriti të dërguarit tonë Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), Tevratit, i cili i zbriti Musait (alejhi selam), Inxhilit, i cili i zbriti Isaut (alejhi selam).

Tre: Besimi në vërtetësinë e atyre lajmeve që janë të vërteta, si lajmet e Kuranit Fisnik.

Besimi në libra është një nga shtyllat e imanit (besimit); siç thotë Allahu i Lartësuar: **“O ju që besuat, besoni vazhdimisht Allahut, të dërguarit të Tij, librit që gradualisht ia shpalli të dërguarit të Tij dhe librit që e pat zbritur më parë. Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dëguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg”**.¹¹³

Allahu pra urdhëroi për besim ndaj Tij, të dërguarve të Tij, dhe librit që iu zbrit të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) - Kuranit Fisnik; ashtu siç urdhëroi edhe të besohet në librat e zbritura para Kuranit; i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) thotë për imanin se është: *“Të besosh Allahun, melaqet, librat, pejgamberët, ditën e Fundit dhe të besosh në caktimin e tij qoftë të mirë apo të keq”*.¹¹⁴

b) Veçoritë e Kuranit Fisnik:

Kurani Fisnik është fjalë e Allahut të Madhëruar, i zbritur të dërguarit, shëmbëlltyrës sonë Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të); prandaj qysh këtu besimtari fillon ta madhërojë këtë Libër, vepron në ujdi me dispozitat e tij, e lexon dhe mediton atë.

¹¹³ Sureja Nisa, 136.

¹¹⁴ E transmeton Muslimi, me numër 8.

Pra, na mjafton fakti se ky Kuran është udhëzuesi jonë në këtë botë dhe shkak i shpëtimit në botën tjetër.

Kurani ka karakteristika dhe veçori të shumta me të cilat veçohet nga librat e kaluar qiellor; siç janë:

1 - Kurani Fisnik përmban rezymenë e dispozitave hyjnore, dhe ka zbritur si ndihmës dhe vërtetues i asaj që ishte në librat e mëhershëm, siç është urdhërimi për adhurimin e Allahut Një; Allahu thotë: **“Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur’anin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre.”**¹¹⁵

Kuptimi i fjalës “vërtetues i librave të mëparshëm” është se ky Kuran vërteton atë çfarë ishte e vërtetë prej atyre librave; ndërsa kuptimi i fjalës “dhe garantues i tyre” është: sigurues dhe dëshmues i asaj që ka ekzistuar më herët në këta libra.

2 - Kapja për këtë Kuran Famëlartë është obligim për të gjithë njerëzit; të gjitha krijesat janë të detyruara ta pasojnë Kuranin dhe të veprojnë me të, për dallim nga librat e mëhershëm të cilët ishin të dedikuar vetëm popujve përkatës; Allahu thotë: **“(Profeti thotë:) Mua më është shpallur ky Kur’an që me të t’ju tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet.”**¹¹⁶

3 - Allahu i Madhëruar ka garantuar ruajtjen e Kuranit Fisnik, në të nuk futet dora e ndryshimit; siç thotë Allahu: **“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur’anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”**¹¹⁷

c) Obligimi jonë ndaj Kuranit Fisnik:

Pasi që u njohëm me disa karakteristika dhe veçori madhështore dhe të veçanta të Kuranit Fisnik, atëherë cili është obligimi jonë drejtë Kuranit?

- Jemi të obliguar ta duam Kuranin, ta madhërojmë dhe ta nderojmë atë, sepse është fjalë e Krijuesit (az-ze ve xhel-le), pra është thënia më e vërtetë dhe më e çmuar.

- E kemi për obligim ta lexojmë, të meditojmë ajetet dhe suret e Kuranit, të mendojmë rreth këshillave të Kuranit, lajmeve dhe tregimeve të tij.

- E kemi për obligim të pasojmë dispozitat e tij, t’i respektojmë urdhrat dhe ndalesat e tij. Është pyetur Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) për moralin e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), dhe ka thënë: “Moralin e tij ishte Kurani”.¹¹⁸

Kuptimi i hadithit është se ai, i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), ishte shembulli praktik i dispozitave të Kuranit dhe ligjeve të tij. Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka realizuar pasimin e përsosur të udhëzimit të Kuranit; prandaj, që nga këtu bëhet obligim për të gjithë pasimi i të dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e

¹¹⁵ Sureja Maide, 48.

¹¹⁶ Sureja EnAmë, 19.

¹¹⁷ Sureja Hixhr, 9.

¹¹⁸ E transmeton Ahmedi, me numër 25108.

Allahut qofshin mbi të) si shëmbëlltyra më e mirë për secilin prej nesh; siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën jetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.”**¹¹⁹

d) Falsifikimi i librave të mëparshëm:

Allahu i Madhëruar na ka informuar në Kuranin Fisnik se ithtarët e librit, prej çifutëve dhe të krishterëve, kanë ndryshuar librat e tyre, prandaj ata nuk mbetën në formën e tyre të vërtetë në të cilën Allahu i Madhëruar i kishte zbritur.

Çifutët ndryshuan Tevratin, zëvendësuan dhe luajtën me dispozitat e Tevratit, Allahu thotë: **“Një palë nga jehuditë është që ndryshojnë fjalët (e Zotit) nga vendet e veta.”**¹²⁰

Po ashtu edhe të krishterët ndryshuan Inxhilin, zëvendësuan dispozitat e tij; Allahu thotë: **“Në të vërtetë, një grup prej tyre janë ata që pështjellojnë gjuhët e tyre kur lexojnë librin (për ta deformuar kuptimin) ashtu që ju të mendoni se ajo (shprehje) është nga libri, po ajo nuk është nga libri (i vërtetë), madje thonë: “Kjo është nga Allahu”! Po ajo nuk është nga Allahu. Ata duke ditur thonë gënjeshtër për Allahun.”**¹²¹

Tevrati që ekziston tani nuk është ai Tevrat që iu zbrit Musait (alejhi selam), e as Inxhili që ekziston sot nuk është ai Inxhil që i zbriti Isait (alejhi selam).

Tevrati dhe Inxhili të cilët janë në duart e ithtarëve të librit përmbajnë besime të dëmshme, lajme të pabaza, rrëfime të rreme; për këtë arsye, ne i pranojmë si të vërteta nga këto libra vetëm ato që Kurani Fisnik ose suneti i vërtetë i ka vërtetuar, dhe përgënjeshtrojmë atë që Kurani dhe suneti përgënjeshtrojnë.

e) Dobitë e besimit në Libra:

Besimi në libra sjellë shumë dobi; prej tyre do të përmendim:

1 - Dituria për kujdesin e Allahut të Madhëruar ndaj robërve të Tij, dhe për mëshirën e Tij absolute, sa që i zbriti çdo populli libër për t’u udhëzuar përmes tij; pastaj realizimi i lumturisë për ta në këtë botë dhe botën tjetër.

2 - Dituria për urtësinë e Allahut në ligjëvënje, sa që ligjësoi për çdo popull atë që iu përshtat gjendjes së tyre, dhe ishte në ujdi me individët; siç thotë Allahu: **“Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit).”**¹²²

3 - Falënderimi për dhuntinë e Allahut që zbriti ato libra; duke qenë se këto libra janë dritë dhe udhëzim në dynja dhe botën tjetër, prandaj qysh prej këtu na na bëhet obligim falënderimi ndaj Allahut për këto dhunti të mëdha.

¹¹⁹ Sureja Ahzab, 21.

¹²⁰ Sureja Nisa, 46.

¹²¹ Sureja Ali Imran, 78.

¹²² Sureja Maide, 48.

BESIMI NË PEJGAMBERË

a) Nevoja e njerëzimit për fenë:

Feja është e domosdoshme për njerëzit, është diçka që patjetër duhet ta kenë. Nevoja e tyre për të qëndron mbi çdo nevojë tjetër, sepse mesazhi hyjnor është shpirti i gjithë botës, drita dhe jeta e saj. Çfarë mirëqenie e botës do të ekzistonte po të mos ishte shpirti, jeta e drita? Kjo botë është e errët, pos asaj çfarë ka ndriçuar dielli i mesazhit hyjnor. Nuk ka rrugë tjetër për te lumturia e shpëtimi në të dy botët pos përmes duarve të të dërguarve; nuk ka rrugë për ta njohur të mirën dhe të keqen në detaje pos nëpërmjet këtyre.

Allahu e ka quajtur mesazhin e Tij shpirt, prandaj nëse shpirti mungon, aty mungon edhe jeta; Allahu thotë: **“Po kështu me urdhrin tonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (Kur’anin). Ti nuk ke ditur çka është libri (Kur’ani) as ç’është besimi, por Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve tanë. Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë.”**¹²³

Të besuarit në pejgamberët është një prej kushteve të besimit, Allahu thotë: **“I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij.”**¹²⁴

Ky ajet aludon për obligueshmërinë e besimit në të gjithë pejgamberët (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ta), duke mos dalluar mes tyre; pra nuk besojmë në disa prej pejgambereve e të mohojmë disa të tjerë, siç është gjendja e çifutëve dhe të krishterëve.

Pastaj i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) tha për imanin; “... ai është: “Të besosh Allahun, melaqet, librat, të dërguarit, ditën e Fundit dhe të besosh në caktimin e Tij, qoftë i mirë apo i keq”.

Ajo nga e cila ankohen shtetet, të ashtuquajturat shtete të përparuara e të civilizuara, janë çrregullimet, brengat, fatkeqësitë e shkëputjet e shumta është për shkak refuzimit të mesazhit.

b) Kuptimi i besimit në pejgamberë:

Besimi i prerë se Allahu ka dërguar tek çdo umet pejgamberë nga mesi i tyre, që t'i thërrasin në adhurimin e Allahut Një, të pa rival, dhe se të gjithë pejgamberët janë të vërtetë dhe flasin vetëm të vërtetën; ata janë të devotshëm e të besueshëm, udhëzues e të udhëzuar, se ata kanë kumtuar gjithë atë me çka i dërgoi Allahu, e nuk fshehën e as ndryshuan gjë prej saj; e as nuk kanë shtuar nga vetja asnjë shkronjë e as kanë mangësuar; siç thotë Allahu: **“Po a mos kanë të dërguarit obligim tjetër, përveç që t'i njoftojnë qartazi?”**¹²⁵

¹²³ Sureja Shura, 52.

¹²⁴ Sureja Bekare, 285.

¹²⁵ Sureja Nahl, 35.

Të gjithë të dërguarit kanë qenë në të vërtetën e qartë, thirrja e tyre ka qenë e unifikuar për të besuar njëshmërinë; siç thotë Allahu: **“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)”**”¹²⁶

Ligjet e pejgamberëve mund të ndryshojnë në gjëra dytësore që kanë të bëjnë me hallallin dhe haramin; siç thotë Allahu: **“Për secilin prej jush, Ne caktoam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit)”**¹²⁷

Të besuarit në pejgamberë përfshin katër gjëra:

Një: Besimi se pejgamberllëku i tyre është i vërtetë nga Allahu i Madhëruar, prandaj kush mohon pejgamberllëkun e njërit prej tyre, ai i ka mohuar të gjithë.

Dy: Besimi në çdo pejgamber të autorizuar nga Allahu me shpallje, si: Muhamedin, Ibrahimin, Musain, Isain, Nuhun (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ta), ndërsa atij që nuk ia dimë emrin e besojmë ashtu në përgjithësi.

Tre: Besimi në vërtetësinë e lajmeve të pejgamberëve.

Katër: Të vepruarit me ligjin e të dërguarit i cili na u dërgua neve, duke qenë se ai është më i dalluari dhe është vula e tyre, Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

c) Kuptimi i emrit “Nebij” dhe “Rasul”:

Emri “Nebij” në aspektin gjuhësor të gjuhës arabe ka për qëllim: Lajmëtar, e që është emër i nxjerrë prej fjalës “Nebe” – lajm; pra nebij (lajmëtar) është ai që përcjell lajme nga Allahu i Madhëruar; dhe thonë se është nxjerrë nga “Nubuve” që do të thotë vend i ngritur, pra nebij (lajmëtar) është krijesa më e nderuar dhe më e ngritur.

Ndërsa kuptimi i fjalës “nebij” në terminologjinë fetare ka për qëllim: njeri i lirë, mashkull, të cilin Allahu e ka zgjedhur dhe e ka veçuar për kumtimin e shpalljes.

Emri “Rasul” në aspektin gjuhësor është: ai i cili përcjell lajmet e atij që e ka dërguar.

Ndërsa kuptimi i emrit “resul” (i dërguar) në terminologjinë fetare është: njeri i lirë, mashkull, që Allahu e ka lajmëruar atë me ligj, dhe e ka urdhëruar të përcjellë atë tek populli kundërshtues.

Dallimi mes tyre është se “Rasul” është më i veçantë se “Nebij”, pra çdo rasul është nebij, por jo çdo nebij është rasul, ngase rasuli urdhërohet t’ia kumtojë ligjin atij që ka kundërshtuar fenë e Allahut apo nuk e di fenë e Allahut, ndërsa nebij dërgohet thirrës në ligjin që ka qenë prezent më herët.

d) Virtytet dhe shenjat e të dërguarve:

¹²⁶ Sureja Nahl, 36.

¹²⁷ Sureja Maide, 48.

Prej virtyteve të të dërguarve është se ata janë njerëz, pra kanë nevojë për ushqim e pije ashtu siç kanë nevojë njerëzit e tjerë; Allahu thotë: **“Ne edhe para teje nuk dërguam tjetër pos burra, të cilëve u dhamë shpallje.”**¹²⁸

Poashtu, edhe të dërguarit i godet ajo që i godet njerëzit e tjerë, sëmuren, u vije vdekja, si çdo njeri.

Pra ata nuk kanë ndonjë veçori hyjnore të zotërimit të gjithësisë (rububije) apo meritës për të qenë të adhuruar (uluhije), por ata janë njerëz të cilët kanë arritur përsosmërinë në krijimtarinë e jashtme, ashtu siç kanë arritur kulmin në përsosmërinë e moralit; ata janë njerëzit më të mirë për nga prejardhja, kanë logjikë të shëndoshë, gjuhë të qartë që i bën ata të jenë meritore të bartin përgjegjësinë e mesazhit dhe të bartin barrën e lajmëtarëve.

Pra, na u bë e qartë se urtësia e dërgimit të të dërguarve prej llojit të njerëzve është që ata të jenë shëmbëlltyrë për njerëzit, ndërsa ky pasim i njerëzve ndaj tyre është jashtë mundësive apo kompetencave të tyre si pejgamberë.

Prej veçorive të pejgamberëve është se Allahu i ka veçuar ata nga njerëzit e tjerë me shpallje; Allahu thotë: **“Thuaj: “Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj.”**¹²⁹

Allahu i ka zgjedhur dhe i ka pastruar ata për dallim nga njerëzit tjerë; Allahu thotë: **“Allahu e di më së miri se ku ta vëjë dërgesën (risalen) e vet.”**¹³⁰

Prej cilësive të pejgamberëve është se ata janë të mbrojtur në atë që e kumtojnë nga Allahu, pra ata nuk gabojnë në kumtimin e fesë nga Allahu e as në praktikimin e asaj që Allahu u ka shpallur atyre.

Cilësi të profetëve janë: Sinqeriteti; pra, të dërguarit (alejhimus-selam) janë të sinqertë në thëniet dhe veprat e tyre; Allahu thotë: **“E, kjo është ajo që premtoi Zoti dhe vërtetuan të dërguarit.”**¹³¹

Prej cilësive të tyre është edhe durimi; të dërguarit ishin përgëzues dhe kërcënues në thirrjen e tyre për në fenë e Allahut të madhëruar; ata i ka goditur llojlloj dëmi e vështirësie por megjithatë kishin durim dhe tejkalonin vështirësitë në rrugë të Allahut, vetëm për të ngritur lart fjalën e Allahut; prandaj Allahu thotë: **“Ti (Muhammed) duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur.”**¹³²

Sa u përket shenjave të të dërguarve, Allahu i Madhëruar i ka ndihmuar të dërguarit e Tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta) me mrekulli të qarta, argumente të forta që aludojnë në vërtetësinë e tyre, në vërtetësinë e pejgamberllëkut, dhe Allahu çoi në duart e të dërguarve mrekulli të jashtëzakonshme që nuk janë në mundësitë e njeriut, për të konfirmuar vërtetësinë dhe për të pohuar pejgamberllëkun.

¹²⁸ Sureja Enbija, 7.

¹²⁹ Sureja Kehf, 110

¹³⁰ Sureja EnAm, 124.

¹³¹ Sureja Jasin, 52.

¹³² Sureja Ahkaf, 35.

Definicioni i shenjave dhe mrekullive profetike është: Ato janë gjëra të pazakonta të cilat Allahu i shfaqë në duart e lajmëtarëve dhe të dërguarve të Tij, në një mënyrë e cila pamundëson që dikush tjetër prej njerëzve të vijë me diçka të tillë.

Prej këtyre mrekullive dhe argumenteve janë edhe: njoftimi që Isai (alejhi selam) ia bënte popullit të tij rreth gjithë asaj çfarë hanin dhe ruanin në shtëpitë e tyre; Pastaj, shkopi i Musait (alejhi selam) i cili shndërrohej në gjarpër; Çarja e hënës si mrekulli e të dërguarit tonë Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

e) Urtësia e dërgimit të peygamberëve:

Allahu i dërgoi të dërguarit e Tij për t'i mësuar njerëzit për të Adhuruarin e tyre të vërtetë, dhe për t'i thirrur ata në adhurimin e Allahut Një, të pa shok.

Allahu i dërgoi Profetët që ta ngrisin fenë dhe të ndalojnë nga përçarja; prandaj Allahu thotë: **“Ai ju përcaktoi juve për fé atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të.”**¹³³

Allahu i dërgoi Profetët që të përgëzojnë dhe të tërheqin vërejtje; Allahu thotë: **“Ne të dërguarit nuk i dërgojmë ndryshe vetëm si përgëzues dhe qortues.”**¹³⁴

Përgëzimi dhe qortimi i të dërguarve ka të bëjë me këtë botë dhe me botën tjetër. Në këtë botë ata përgëzojnë njerëzit e bindur për një jetë të mirë: **“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë).”**¹³⁵

Dhe ua tërheqin vërejtjen nga dënimi dhe shkatërrimi në këtë botë: **“Në qoftë se ata nuk përgjigjen, ti thuaj: “Unë tërhoqa vërejtjen e një rrufeje (dënimi), si rrufeja e Adit dhe Themudit!”**¹³⁶

Ndërsa për në botën tjetër ata përgëzojnë ata që janë të bindur me Xhenetin dhe me kënaqësitë e tij: **“Kush i bindet Allahut, (urdhërave të Tij) dhe të dërguarit të Tij, atë e dërgon në xhennete nën të cilin burojnë lumenj. Aty do të jenë përgjithmonë. E ky është shpëtim i madh.”**¹³⁷

Kriminelët dhe mëkatarët i frikësojnë me dënimin e Allahut në ahiret: **“Kush e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, dhe i shkel dispozitat e Tij, atë e shtie në zjarr të përjetëshëm. E për të është një dënim i rëndë.”**¹³⁸

Allahu i dërgoi të dërguarit që t'u japin njerëzve shembull të mirë në sjellje, moral dhe mënyrën e drejtë të adhurimit; siç thotë Allahu për të dërguarin tonë Muhamedin (paqja

¹³³ Sureja Shura, 13.

¹³⁴ Sureja EnAm, 48.

¹³⁵ Sureja Kehf, 56.

¹³⁶ Sureja Fusilet, 13.

¹³⁷ Sureja Nisa, 13.

¹³⁸ Sureja Nisa, 14.

dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): **“Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën jetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.”**¹³⁹

- f) Të besuarit në Muhamedin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) si lajmëtar dhe i dërguar:
- Besojmë që Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është rob dhe i dërguar i Allahut, si dhe zotëriu i të parëve dhe të fundit, është vulë e pejgamberisë pas të cilit s’ka më pejgamber; ka zbatuar misionin e tij, ka realizuar amanetin, ka këshilluar umetin dhe ka luftuar në rrugë të Allahut ashtu siç duhet.
 - Duhet ta besojmë atë që ai na e rrëfen, t’i bindemi atij në atë me të cilën na ka urdhëruar, të largohemi prej asaj prej të cilës na ka ndaluar apo ai vetë i është shmangur; ta adhurojmë Allahun në pajtim me sunetin e tij, ta pasojmë vetëm atë; prandaj Allahu thotë:

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”¹⁴⁰

- Duhet t’i japim përparësi dashurisë së tij ndaj dashurisë së prindërve, fëmijëve dhe gjithë njerëzimit; ashtu siç tha (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Nuk ka besuar askush prej jush përderisa unë të mos jem më i dashur për të sesa prindi i tij, fëmija i tij dhe të gjithë njerëzit”.¹⁴¹

Dashuria e singërtë arrihet duke pasuar sunetin dhe udhëzimin e tij.

Lumturia reale dhe udhëzimi i plotë nuk realizohen ndryshe pos duke respektuar atë; siç thotë Allahu: **“E, nëse i përuleni atij, do të jeni në rrugën e drejtë; - e Pejgamberi vetëm është i detyruar që t’ju shpallë qartazi.”**¹⁴²

- Jemi të obliguar që ta pranojmë të gjithë atë me me të cilën erdhi i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), të ndjekim sunetin e tij, ndërsa udhëzimin e tij duhet ta vendosim në një pozitë madhërimi e nderimi; siç thotë Allahu: **“Betohem në Zotin tënd, se ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, përderisa mos të marrin ty për arbitër, për ato konflikte që ekzistojnë ne mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dëshprimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.”**¹⁴³
- Duhet të kemi kujdes nga kundërshtimi i urdhërit të tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), sepse kundërshtimi i urdhërit të tij është shkaktar i sprovave, devijimeve e dënimeve të dhembshme; prandaj Allau thotë: **“Le të druajnë ata që i kundërshtojnë urdhërit të tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godas ata dënimi i dhembshëm.”**¹⁴⁴

¹³⁹ Sureja Ahzab, 21.

¹⁴⁰ Sureja Ahzab, 21.

¹⁴¹ Buhariu (15), Muslimi (44), Nesaiu (5013), ibn Maxhe (67), Ahmedi (3/278), Darimiu (2741).

¹⁴² Sureja Nur, 54.

¹⁴³ Sureja Nisa, 65.

¹⁴⁴ Sureja Nur, 63.

g) Veçoritë e mesazhit Muhamedan:

Ky mesazh dallohet prej mesazheve të mëhershme me një sërë veçorish:

- Mesazhi Muhmedan është vula e mesazheve të mëparshme; Allahu thotë: **“Muhammedi nuk është babë i askujt prej njerëzve (meshkujve) tuaj, por është Pejgamber i Allahut dhe vula e pejgamberëve.”**¹⁴⁵
- Ky mesazh është shfuqizues i mesazheve të mëparshme, prandaj Allahu nuk pranon fe tjetër prej askujt përveç prej atyre që pasuan të dërguarin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), dhe askush tjetër nuk do të arrijë deri te kënaqësitë e Xhenetit pos sipas rrugës së tij. Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është më bujari i pejgamberëve, umeti i tij është umeti më i mirë, ndërsa legjislacioni (sheriati) i tij është sheriati më i plotë.

Allahu thotë: **“E ai që kërkon tjetër fe përveç islamizmit, nuk do t’i pranohet, dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”**¹⁴⁶

I dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk ndodh që dikush prej këtij umeti të dëgjojë për mua, çifut qoftë apo i krishterë, pastaj të vdesë pa besuar në atë që më është zbritur, veçse do të jetë prej banorëve të Jzarrit.”¹⁴⁷

- Mesazhi është i përgjithshëm për të dyja llojet e krijesave të obliguara: Xhindët dhe njerëzit.

Allahu përmend fjalën e njërit prej xhindëve në Kur’an: **“O populli ynë, përgjigjuni ju grishtarit të Allahut.”**¹⁴⁸

Dhe Allahu thotë: **“Na të kemi dërguar ty për tërë njerëzimin – sihariques dhe paralajmërues, por shumica e njerëzve nuk dine.”**¹⁴⁹

I dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Jam dalluar prej të dërguarve të tjerë me gjashtë gjëra: më është dhënë aftësia e të folurit me aforizëm, jam ndihmuar me frikën (e jobesimtarëve) ndaj meje, më është lejuar plaçka e luftës, e gjithë toka më është bërë e pastër dhe vendfalje, jam dërguar për të gjitha krijesat, dhe më është dhënë vula e gjithë vargut të pejgamberëve.”¹⁵⁰

h) Efektet e besimit në të dërguarit:

Besimi në të dërguarit e Allahut ka efekte të mëdha, prej tyre do të përmendim:

¹⁴⁵ Ahzab, 40.

¹⁴⁶ Sureja Ali Imran, 85.

¹⁴⁷ Muslimi, (153), Ahmedi (2/317).

¹⁴⁸ Sureja Ahkaf, 31.

¹⁴⁹ Sureja Sebe, 28.

¹⁵⁰ Buhariu (2815), Muslimi (523), Nesaiu (3089), Ahmedi (2/412).

- 1- Kuptimi i mëshirës dhe kujdesit të Allahut për robërit e tij, duke qenë se Ai i dërgoi të dërguarit për t'i udhëzuar ata në rrugën e vërtetë, dhe për t'ua sqaruar mënyrën se si ta adhurojnë Allahun, sepse logjika njerëzore nuk mund të arrijë ta kuptoj një gjë të tillë. Allahu i Madhëruar thotë për të dërguarin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): **“Dhe, Na të kemi dërguar ty (o Muhamed!) vetëm si mëshirë për botërat – njerëzit.”**¹⁵¹
- 2- Falënderimi ndaj Allahut për këtë dhunti të madhe.
- 3- Dashuria ndaj të dërguarve (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi ta), si dhe madhërimi e lavdërimi i tyre ashtu siç e meritojnë, ngase ata e zbatuan adhurimin ndaj Allahut, kumtimin e fesë, dhe këshilluan robërit e Allahut.
- 4- Ndjekja e porosive me të cilat erdhën të dërguarit si dhe zbatimi i tyre, për t'u reliazuar kështu në jetën e besimtarëve mirësia, udhëzimi dhe lumturia e dy botëve.

Allahu thotë: **“e kush pason udhëzimin Tim, nuk do të humbë (në këtë botë), as që do të jetë fatkeq (në botën tjetër) E, ai që shmanget nga Libri Im, ai do të ketë jetë të vështirë.”**¹⁵²

BESIMI NË DITËN E FUNDIT

- a) Kuptimi i besimit në ditën e Fundit:

Besimi i prerë se ajo do të ndodhë padyshim dhe veprimi sipas asaj me të cilën jemi obliguar në raport me të, e që nënkupton të besohet në shenjat e Kiametit të cilat vijnë para ndodhisë, të besojmë në vdekje dhe në gjithë atë që ndodh më pas që prej sprovës së varrit, ndëshkimit apo mirëqenies në fryerjen e surit, e deri te dalja e krijesave nga varret, ndodhitë e Ditës së Kijametit, frikës, trishtimit, si dhe detajet tjera të ringjalljes si: shpërndarja e regjistrave, vendosja e peshoreve, qëndrimi në rrugën e siratit, Havdi (kroi i Profetit), ndërmjetësimi, e të tjera. Pastaj, besimi në Xhenetin dhe kënaqësitë e tij, prej të cilave më e madhja është shikimi në fytyrën e Allahut; pastaj besimi në Zjarrin dhe dënimin e tij; dhe në fund besimi se dënimi më i madh është pengesa e robit nga Zoti i tij (aze ve xhel).

- b) Vëmendja e Kuranit ndaj kësaj shtylle dhe urtësia e tij:

Kurani Famëlartë është i mbushur me përmendjen e Ditës së Fundit, prandaj i ka kushtuar rëndësi pohimit të çdo ndodhie. Ka tërhequr vërejtjen herë pas here, ka konfirmuar ndodhjen e saj në çdo formë të mundshme të gjuhës arabe. Prej llojeve të vëmendjes që Libri i Allahut i kushtoi kësaj Dite të madhe është se ajo shumë herë lidhet drejtpërdrejt me besimin në Allahun e Lartësuar. Si për shembull në Fjalën e Allahut: **“Kështu këshillohet çdokush prej jush që beson Allahun dhe Ditën e Kijametit.”**¹⁵³

¹⁵¹ Sureja Enbija, 108.

¹⁵² Sureja Taha, 123-124.

¹⁵³ Sureja Bekare, 232.

Gjithashtu prej llojeve të tjera është edhe përmendja e shpeshtë në Kuran, saqë nuk mund të kalosh një fletë prej fletëve të Kuranit veçse do të gjeshë diçka rreth ditës së Kiametit, e asaj se çfarë do të ndodhë në forma të llojllojshme.

Prej llojeve të ndryshme të vëmendjes që i kushtoi Kur’ani kësaj Dite është emërtimi i saj me emra të shumtë e të ndryshëm, me emra që aludojnë në vërtetësinë e kësaj ndodhie, si për shembull: El Hakah (Çasti i së vërtetës), El Vakiah (Ngjarja), El Kijameh (Ditë e Gjykimit).

Disa nga këta emra tregojnë trishtimin e madh që do të ndodhë, siç janë: Gashijeh (Fatkeqësie e kaplueshme), Tameh (Vështirësi), Sakhah (Zë i madh), Ka’riah (Goditja e tmerrshme).

Emrat e tjerë të ditës së Fundit në Kur’an janë: Jevmu Din, Jevmul Hisab (Dita e llogaritjes), Jevmul Xhem’ (Dita e tubimit), Jevmul Hulud (Dita e përjetësisë), Jevmul Huruxh (Dita e daljes nga varret), Jevmul Haserah (Dita e dështimit), Jevmu Tenad (Dita e ringjalljes).

Ndërsa urtësia e vëmendjes së madhe ndaj saj tregon se besimi në ditën e Fundit ka një ndikim shumë të madh në drejtimin, përqendrimin dhe përkushtimin e njeriut në vepra të mira dhe në devotshmëri ndaj Allahut (aze ve xhel). Dhe kjo është ajo në çfarë aludon edhe metodika Kuranore; lidhja e besimit në ditën e Fundit me veprën e mirë; e kësaj natyre është Fjala e Allahut: **“Tempujt (xhamitë) e Allahut i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit.”**¹⁵⁴

“Ata që besojnë në jetën e ardhshme besojnë edhe në të (Kur’an) dhe ata kujdesen për kryerjen e namazit të tyre.”¹⁵⁵

Ndoshta prej urtësive të përmendjes së shpeshtë të Ditës së Fundit është edhe harresa e shpeshtë e kësaj dite nga njeriu dhe anashkalimi i përkujtimit të saj, për shkak të lidhjes së njeriut me këtë botë, dashurisë ndaj kënaqësive të kësaj bote, prandaj besimi në të dhe në gjërat që do të ndodhin atë ditë, duke përfshirë ndëshkimet dhe kënaqësitë e saj, mund të jetë shkak për pakësimin e dashurisë së tepërt ndaj kësaj bote, dhe shtytës për të garuar në kryerjen e më shumë adhurimeve; Allahu thotë: **“O besimtarë! Çka kini që ngurroni, - thuajse jeni ngjitur për tokë – kur ju thuhet: “Dilni në luftë, në rrugën e Perëndisë! A jeni të kënaqur me jetën e kësaj bote, në vend të përhershmes (amshueshmës). E, kënaqësia e kësaj bote, në krahasim me atë të botës tjetër – është shumë e vogël.”**¹⁵⁶

Nuk ka gjë që e ngritë njeriun – pas besimit në Allahun – më shumë sesa besimi në Ditën e Fundit; besimi se çdo kënaqësi në jetën e kësaj bote të cilën njeriu do ta braktisë – si bindje dhe përkushtim ndaj urdhërit të Allahut – Allahu do t’ia kompensojë atë në botën tjetër me një kënaqësi më të madhe, më të përhershme dhe të pafundme; të besuarit se

¹⁵⁴ Sureja Teube, 18.

¹⁵⁵ Sureja En Am, 92.

¹⁵⁶ Sureja Teube, 38.

çdo dalje nga udhëri i Allahut në jetën e kësaj bote, i shtyrë nga një kënaqësi e përkohshme, do të ndëshkohet me një dënim të dhembshëm në botën tjetër.

Kur njeriu beson në ditën Fundit, ai do të bindet se çdo kënaqësi e kësaj bote nuk mund të krahasohet me atë të botës tjetër, e as që mund t'i kundërvihet një rënieje të vetme në dënim për shkak të saj; dhe çdo dënim i kësaj bote – në rrugë të Allahut – në anën tjetër, nuk mund të krahasohet me dënimin e botës tjetër, e as që mund të barazohet me një rënie të vetme në mirëqenie për shkak të saj.

c) Sprovat e varrit:

Ne besojmë se vdekja është reale, Allahu thotë: **“Thuaju: “Do t’jua merr shpirtin engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju, e pastaj do të ktheheni te Zoti juaj”.**”¹⁵⁷

Kjo është një gjë të cilën të gjithë e dëshmojnë, nuk ka kush që nuk e njeh, dhe nuk ka për të asnjë dilemë apo dyshim. Besojmë se çdonjëri që ka vdekur, apo është vrarë apo për çfarëdo shkakut tjetër ka pësuar vdekjen, kjo ka ndodhur me caktimin e Zotit duke mos iu bërë atij asnjë e padrejtë; prandaj Allahu thotë: **“dhe kur t’i vijë koha e fundit, nuk mund të shtyhet as të shpejtohet, kurrsesi.”**¹⁵⁸

Besojmë në sprovën e varrit: Pyetjet që i shtrohen robit pas varrosjes, pyetjet për Zotin e tij, fenë dhe të dërguarin e tij. Allahu i përforcon ata të cilët kanë besuar me përgjigje të sakta, prandaj besimtari përgjigjet me fjalët: “Zoti im është Allahu, feja ime është islami dhe i dërguari im është Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)”. Ndërsa zullumqarët, Allahu i shmangë ata (nga përgjigjet e drejta) prandaj jobesimtari thotë: “Hë! Hë! Nuk e di.” Pra, hipokriti dhe ai i cili ka dyshuar do të thotë: “Nuk e di, kam dëgjuar njerëzit duke thënë diç pastaj edhe unë thoj ashtu.”

Njashtu besojmë në dënimin e varrit dhe në rehatinë e tij. Dënimi i varrit do jetë për zullumqarët dhe jobesimtarët; Allahu thotë: **“Ah! T’i shohësh zullumqarët kur janë në mundimet e vdekjes, e engjëjt zgjasin duart (për t’ua marrë shpirtin, duke thënë): “Mirrni shpirtërat tuaj!” Sot ju do ndëshkoheni me dënim të poshtëruar për shkak të pavërtetave që i keni thënë për Perëndinë dhe që jeni krenuar (duke mos besuar) versetet e Tij.”**¹⁵⁹

Dhe për parinë e Faraonit: **“zjarri (të cilit) i ekspozohen në mëngjes dhe mbrëmje, e kur të arrijë Çasti (Dita e Kijametit, ju thuhet): “Shpini ithtarët e Faraonit në dënimin më të rëndë!”**¹⁶⁰

Në Sahihun e Muslimit është shënuar hadithi i Zejd ibn Thabit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), i cili transmeton se i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Sikur mos të kisha frikë se nuk do ta varrosni njëri-tjetrin, do ta kisha lutur Allahun që ta dëgjoni dënimin e varrit, të cilin unë e dëgjoj.” Pastaj u drejtua me fytyrë nga ta dhe tha:

¹⁵⁷ Sureja Sexhde, 11.

¹⁵⁸ Sureja Araf, 34.

¹⁵⁹ Sureja En Am, 93.

¹⁶⁰ Gafir, 46.

“Kërkoni mbrojtjen e Allahut nga dënimi i Zjarrit.” Thanë: “Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga dënimi i Zjarrit.” Pastaj tha: “Kërkoni mbrojtjen e Allahut nga dënimi i varrit.” Thanë: “Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga dënimi i varrit.”¹⁶¹

Ndërsa kënaqësia e varrit është për besimtarët e singertë; Allahu i Madhëruar thotë: **“Me të vërtetë, ata që thonë: “Zoti ynë është Perëndia, e pastaj vazhdojnë në të drejtë (sipas urdhërit të Perëndisë), do t’ju zbresin atyre engjëjt (dhe do t’ju thonë): “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni xhennetit që ju është premtuar”**¹⁶²

Allahu thotë: **“E, përse kur t’ju vie shpirti në fytyrë, dhe kur ju atëherë e shikoni atë, e ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk shihni, - e sikur të ishit ju të fuqishëm (e nuk sundon tjetërkush) atëherë do t’ia kthenit (shpirtin atij), nëse thoni të vërtetën? Dhe, nëse është (ai që është në agoni) nga ata që janë afër te Perëndia - (për te ka) komoditet, mëshirë dhe furnizim të madh dhe kopshtet e dhuntive!”**¹⁶³

Bera ibn Azib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmeton se i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), duke treguar se si besimtari i përgjigjet dy melekëve në varr, thotë: “Një thirrës thërret prej qiellit: “të vërtetën e tha rob i Im, shtrojini atij shtrojë të Xhenetit, visheni me tesha të Xhenetit, dhe hapjani atij një derë për në Xhenet.” Pastaj thotë: “Atij i vjen pastaj aroma dhe myshku i Xhenetit dhe e i zgjerohet varri i tij për aq sa sheh syri.”¹⁶⁴

Transmetimet nga i dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) kanë arritur gradën e tevaturit¹⁶⁵ në vërtetimin e dënimit të varrit dhe kënaqësive në të, për atë që është meritë, si dhe për parashtrimin e pyetjeve nga dy melekët. Prandaj, duhet të jemi të bindur për vërtetësinë e kësaj ndodhie dhe të besojmë në të, duke mos iu qasur mënyrës se si ndodh ajo, pasi që mendja nuk mund ta perceptojë mënyrën, sepse nuk ka qenë e sprovuar ndonjëherë me të në këtë botë.

Ngjashëm, edhe çështja e varrit është prej gjërave të padukshme të cilat shqisat nuk mund t’i perceptojnë dot, sepse poqëse këto gjëra do të perceptoheshin me shqisat atëherë do të humbiste dobia e besimit në të të padukshmen, dhe do ta humbiste kuptimin obligueshmëria praktike fetare, pastaj njerëzit do ta braktisnin varrosjen e njëri-tjetrit, siç tha Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Sikur mos të frikësohesha se nuk do ta varrosnit njëri-tjetrin, do ta lusja Allahun që t’ua mundësonte dëgjimin e dënimit në varr ashtu siç unë e dëgjoj;” Ndërsa tek kafshët, pasi që tek ato bie urtësia e përmendur në hadith, ato e dëgjojnë dhe e arrijnë atë.

d) Shenjat e Kiametit:

¹⁶¹ Muslimi 2868, Ahmed i 5/190.

¹⁶² Fusilet, 30.

¹⁶³ Sureja Vakiah, 83-89.

¹⁶⁴ Ebu Davudi 4753, Ahmed i 4/288.

¹⁶⁵ Tevatur – është grada më e lartë e saktësisë së hadithit, pra kur hadithi përcillet nga një numër i madh transmetuesish numër ky që pamundëson që ata të bashkohen në gënjeshtëri.

Nga ajo që duhet besuar është të besojmë se Çasti po vie, nuk ka dyshim në të, dhe se kohën e ndodhjes së tij nuk e di askush pos Allahut, i Cili e fshehi atë nga të gjithë njerëzit pa dallim; Allahu thotë: **“Të pyesin ty kur do të ngjajë Dita e Kijametit. Thuaju: “Atë e di vetëm Zoti im. Kohën kur do të ndodhë ajo do ta tregojë vetëm Ai. (Tmerret e Ditës së Kijametit) do të janë të rënda për qiejtë dhe Tokën, do t’u vijë krejtësisht papritmas. Të pyesin, thuase ti di diçka për të. Thuaj: “Këtë e di vetëm Perëndia; e shumica e njerëzve nuk e kuptojnë këtë (të vërtetë).”**¹⁶⁶

Janë vërtetuar hadithe të shumta nga i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) që sqarojnë shenjat e Kiametit dhe paralajmërimet për të.

Fjalët e tij (alejhi selam) ku ai përmend shenjat e vogla të Kiametit janë të vërteta, dhe shumica e tyre sillen rreth prishjes së njerëzve, shfaqjes së trazirave në mesin e tyre dhe devijimit nga rruga e drejtë e Allahut.

Prej shenjave të vogla janë ato që u përmendën në hadithin e Xhibrilit (alejhi selam) kur ai e pyeti të dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) për Kiametin, e ai i tha: “I pyeturi rreth tij nuk di më tepër për të se vetë pyetësi.” Ai ia ktheu: “Atëherë më trego për shenjat e tij?” Ai tha: “Kur robëresha të lindë zonjën e saj, dhe kur të shohësh këmbëzbathurit ...”¹⁶⁷

Gjithashtu prej shenjave të vogla të Kiametit është edhe ajo çfarë i dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) iu përgjigj një njeriu kur ai e pyeti se: “Kur do ndodh Kiameti?” Ai iu përgjigj: “Kur të humbet amaneti prite Kiametin.” Tha: “E si humbet (amaneti)?” Iu përgjigj: “Kur i jepet përgjegjësia atij që nuk e meriton, prite Kiametin.”¹⁶⁸

Ndërsa shenjat e mëdha janë ato paralajmërimet e afërta të cilat do të ndodhin mu para Kiametit, dhe të cilat dihet se do të vijnë njëra pas tjetrës sikurse kokrrat e rruzave kur u këputet peri.”

Në transmetime të vërteta janë përmendur dhjetë prej tyre. Në hadithin e Hudhejfe ibn Usejid el Gifari (Allahu qoftë i kënaqur me të) i cili thotë: “Na erdhi i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) derisa ne ishim duke përkujtuar, dhe na tha: “Çfarë po përkujtoni?” Thanë: “Po përkujtojmë Ndodhinë (Kiametin).” Tha: “Ajo nuk do të ndodh përderisa t’i shihni dhjetë ndodhi,” pastaj përmendi: Tymin, Dexhallin, Kafshën, Lindjen e Diellit nga perëndimi, zbritjen e Isait birit të Merjemes, Jexhuxhët dhe Mexhuxhët, tri shafitjet: një në lindje, një në perëndim dhe një në gdishullin arabik, dhe të fundit prej tyre përmendi: një zjarr që do të del prej Jemenit, i cili do t’i ndjek njerëzit drejt vendit të tubimit (mah’sherrit).”¹⁶⁹

Tani do të ilustrojmë njërin prej këtyre paralajmërimeve të mëdha. Prej shenjave është edhe shfaqja e Dexhallit. Ai është burim i kufrit dhe i devijimit, burim i fitneve dhe i frikës. Të gjithë profetët kishin paralajmëruar popujt e tyre nga Dexhalli, kishin tërhequr vërejtjen

¹⁶⁶ Sureja Araf, 187.

¹⁶⁷ Buhariu, 4499, Muslimi 10, Nesaiu 4991, ibn Maxhe 64, Ahmedi 2/426.

¹⁶⁸ Buhariu 59, Ahmedi 2/361.

¹⁶⁹ Muslimi 2901, Tirmidhiu, 2183, Ebu Davud 4311, ibn Maxhe 4055, Ahmed 4/7.

prej tij dhe e kishin përshkruar qartë atë; e kishin përshkruar me cilësitë e tij të vërteta. Edhe Mustafaja¹⁷⁰ (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), tërhoqi vërejtjen prej tij, e përshkroi atë për umetin e tij me cilësi të cilat janë të qarta për çdo njeri që sheh.

Enesi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) përcjell se i dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Nuk ka ndonjë pejgamber e të mos ia ketë tërhequr vërejtjen umetit të tij nga qenja e tij i verbër në njërin sy dhe gënjeshtar. Ai vërtetë është me njërin sy të verbër, ndërsa Zoti juaj nuk është me njërin sy të verbër, dhe midis “syve” të tij (Dexhalit) shkruan “k, f, r “ (kufër – mosbesim).”¹⁷¹

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmeton se i dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “A dëshironi t’ju tregoj diçka për Dexhallin për ç’gjë nuk i ka treguar (më parë) asnjë pejgamber popullit të tij?! Ai është me një sy të verbër, dhe ai do të paraqitet me Xhenetin dhe Zjarrin (në duart e tij); prandaj ajo për të cilën ai u thotë se është Xheneti, (dijeni se) ai është Zjarri; Unë ju paralajmëroj ashtu siç e paralajmëroi Nuhu popullin e tij.”¹⁷²

Nuk ka shpëtim nga fitneja e Dexhallit pos duke u furnizuar me dije dhe vepra. Sa i përket dijes, duke e ditur se edhe ai (Dexhalli) ka trup, ha dhe pi, e pastaj mangësitë dhe paaftësitë e tij përfshijnë se: është me një sy të verbër, i shkruan mes dy syve se është jobesimtar (Kafir). Ndërsa sa i përket veprave, duke kërkuar mbrojtjen e Allahut nga fitnet e tij, qoftë në teshehudin e fundit të çdo namazi, apo përmes mësimit të dhjetë ajeteve të para të sures Kehf, duke u mbështetur në fjalën e tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Kush i mëson përmendësh dhjetë ajetet e para të sures Kehf është i mbrojtur nga Dexhalli.”¹⁷³

e) Ringjallja:

Besimi në ringjallje ashtu siç aludon në të Kurani dhe Suneti, logjika e shëndoshë dhe natyrshmëria e shëndoshë. Besojmë bindshëm se Allahu do t’i ringjallë të gjithë nga varret, shpirtrat do të kthehen në trupa dhe njerëzit do të ngriten para Zotit të gjithësisë.

Allahu thotë: **“Mandej, pas kësaj ju do të vdisni, pastaj, ju me të vërtetë, do të ringjallen në Ditën e Kijametit.”**¹⁷⁴

I dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Njerëzit do të ringjallen në Ditën e Kiametit këmbëzbathur, të zhveshur dhe të pa bërë synet.”¹⁷⁵

Muslimanët janë të njëzëshëm rreth vërtetësisë së ringjalljes; kjo njëherit është tregues se gjithçka ka ndodhur me urtësinë e Allahut, duke qenë se Ai ka bërë për këto krijesa një vendkthim në të cilin do t’i shpërblejë ata për çdo gjë me të cilën ishin të obliguar përmes

¹⁷⁰ Prej emrave të Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është edhe emri Mustafa – I zgjedhuri.

¹⁷¹ Buhariu 6712, Muslimi 2933, Tirmidhiu 2245, Ebu Davudi 4316, Ahmedi 3/290.

¹⁷² Buhariu 3160, Muslimi 2936.

¹⁷³ Muslimi 809, Tirmidhiu 2776, Ebu Davudi 4323, Ahmedi 5/196.

¹⁷⁴ Sureja Muminun, 15-16

¹⁷⁵ Buhariu 434, Muslimi 2860, Tirmidhiu 3167, Nesaiu 2087, Ahmed 1/253, Darimiu 2803.

gjuhës së të dërguarve; Prandaj Allahu thotë: **“Mos vallë, keni menduar ju, që Ne ju kemi krijuar juve kot dhe që nuk do të ktheheni te Ne?”**¹⁷⁶

Jobesimtarët mohuan ringjalljen pas vdekjes, duke supozuar se një gjë e tillë është e pamundur; e ky pretendim është i kotë, dhe për këtë aludon si sheriat, ashtu edhe shqisat dhe logjika e shëndoshë.

Sa i takon provave sheriatike, Allahu i Madhëruar thotë: **“Mohuesit kujtojnë se kurrsesi nuk do të ngjallen; thuaju atyre: “Po, për Zotin tim, me siguri do të ngjallen dhe pastaj do të informoheni se ç’keni punuar!” – E, kjo për Perëndinë, është lehtë.”**¹⁷⁷

Allahu thotë: **“E, mohuesit thonë: “Nuk do të vijë Çasti!” Thuaju: “Po! Pasha Zotin tim, i cili i di të gjitha të padukshmet, me siguri do t’ju vie.”**¹⁷⁸

Të gjithë librat qiellorë janë në ujdi për këtë.

E sa i përket shqisave: Allahu i Madhëruar u dha mundësinë njerëzve ta shohin që në këtë botë ringjalljen; Në suren el-Bekare janë përmendur pesë shembuj për këtë, ndërsa ne do të përmendim shembullin e parë: “ ... kur populli i Musait i thanë atij: “Ne nuk do besojmë derisa ta shohim Allahun haptas,” e Allahu ua morri shpirtrat atyre e më pas i ringjalli.”

Rreth kësaj Allahu i Madhëruar, duke iu drejtuar Benu Israilëve thotë: **“dhe (kujtonie), kur i keni thënë Musait: “O Musa! Kurrsesi nuk të besojmë ty pa e parë Allahun për fushë!” – në atë çast ju përlau rrufeja, e ju e patë. Pastaj, pas vdekjes suaj, Na ju ngjallëm juve, që të bëheni falenderues.”**¹⁷⁹

Shembujt e tjerë; Shembulli i dytë ka të bëjë me të vrarin rreth të cilit ishin në hasmëri mes vete Benu Israilët, e Allahu i urdhëroi që ta therrnin një lopë, pastaj me një copë mishi të saj ta godisnin të vrarin, ashtu që i vrari paskëtaj të i njoftonte ata se kush ishte ai që e vrau. Njashtu edhe tregimi i atij popullit, të cilët kishin dalur nga vendbanimi i tyre për të ikur nga vdekja, e Allahu bëri që ata të vdesin e më pas i ringjalli. Ndërsa shembulli i katërt ka të bëjë me tregimin e atij i cili kaloi pranë një fshati, dhe e kishte vënë larg mendjes së tij se Allahu do ta ringjallte ndonjëherë këtë fshat, porse Allahu bëri që ai të vdiste për njëqind vite rresht, e më pas e ringjalli. Dhe shembulli i pestë është tregimi i Ibrahimit (alejhis-selam) me shpendët.

Kur flasim për provat logjike rreth mundësisë së ringjalljes ato janë në dy aspekte:

I pari: se Allahu i Madhëruar krijoi qiejt dhe tokën me gjithë çfarë ka në to. Ai i krijoi ato fillimisht, pra duke qenë se Ai qenka i Fuqishëm që të krijojë një gjë që fare s’ka qenë më parë, atëherë nuk është fare e pamundur që ta rikrijoi atë; Allahu thotë: **“Ai krijon prej asgjëje, dhe Ai e përsëriti atë.”**¹⁸⁰

¹⁷⁶ Sureja Muminun 115.

¹⁷⁷ Sureja Tegabun, 7.

¹⁷⁸ Sureja Sebe, 3.

¹⁷⁹ Sureja Bekare, 55-56.

¹⁸⁰ Sureja Rum, 27.

Allahu i Madhëruar urdhëroi që t'i kundërpërgjigjemi atyre që mohojnë ngjalljen e eshtrave pasi të jenë bërë pluhur: **“Thuaj: “Do t'i ngjallë Ai që i krijoi për herë të parë; Ai i di të gjitha ato që i ka krijuar.”**¹⁸¹

I dyti: edhe toka është e vdekur, e thatë, nuk ka në të asnjë pemë të gjelbër, pastaj zbret mbi të shiu dhe qe ajo pastaj tundet nga gjallëria e gjelbërimit, me gjithfarë lloje bimësh të bukura, Kështu, Ai që është i fuqishëm që ta ngjallë (tokën) pasi të ketë vdekur, është i fuqishëm t'i ngjallë edhe të vdekurit; Allahu thotë: **“Ne nga qielli lëshojmë ujin (shiun) e bekuar dhe bëjmë që me të, të ujiten kopshtijt dhe drithërat që korren. Dhe palmet e hurmës së lartë me kalavesh njëri mbi tjetrin, ushqim për robërit (njerëzit), dhe Ne me shi e ringjallim tokën (visin) e vdekur; e kështu do të jetë edhe dalja (prej tokës – ringjallja).”**¹⁸²

Çdo njeri me mend e di se ai që ka mundësi për një gjë të madhe, është edhe më i fuqishëm për gjërat tjera më të vogla, prandaj kur Allahu i Lartësuar i ka krijuar qiejt dhe tokën, që për nga madhështia e gjerësia e tyre janë krijimtari e çuditshme, atëherë që këtu Ai është edhe më i fuqishëm që t'i ngjallë eshtrat të cilat janë shndërruar në pluhur; Allahu thotë: **“Vallë, a nuk është i pushtetshëm ai që krijoi qiejt dhe Tokën – të krijoi qenie të ngjashme (të ringjallë pas vdekjes)? Po, me të vërtetë, Ai është Krijues i çdo gjëje dhe i Gjithëdijshëm.”**¹⁸³

f) Shfaqja, llogaria dhe leximi i librit:

Besojmë në shfaqjen e njerëzve para Zotit të tyre, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“atë ditë do të ngjajë Dita e Kijametit, dhe do të çahet qielli, e atë ditë do të jetë i thyeshëm, dhe engjëjt do të rrinë anëve të qiellit, kurse atë ditë – tetë grupe engjëjsh do ta mbajnë Arshin (fronin) e Zotit tënd. Atë ditë do të pyeteni (paraqiteni) ju, dhe asnjë fshehtësi e juaj nuk do të mbetet e pazbuluar.”**¹⁸⁴

“Dhe ata do të sillen para Zotit tënd, të radhitur (e atyre u thuhet): “Ju, Na keni ardhur ashtu siç u kemi krijuar herën e parë.”¹⁸⁵

Besojmë edhe në llogarinë; me ç'rast Allahu do t'i llogarisë krijesat, pastaj do të Vetmohet me robin e Tij besimtar duke ia pohuar gjynahet që i ka bërë, gjë që është përshkruar në Kuran dhe sunet; ndërsa jobesimtarët nuk do të llogariten si ata, por do t'u peshohen veprat e mira dhe ato të këqija, për arsye se atyre në esencë u mungojnë veprat e mira, prandaj vetëm u numërohen dhe u llogariten të gjitha veprat e tyre, dhe pastaj ndalohen për t'i pohuar ato.

Allahu thotë: **“ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt: atij që do t'i jepet libri i tij në dorën e tij të djathtë lehtë do të japi llogari, dhe do të kthehet i gëzueshëm te të afërmit e tij; e, atij që do t'i jepet libri i tij pas shpinës, e thërret shkatërrimi dhe në zjarr do të digjet, sepse, (në jetë) ka qenë i gëzueshëm në familjen e tij, dhe ka menduar se kurrë nuk do të kthehet**

¹⁸¹ Sureja Jasin, 79.

¹⁸² Sureja Kaf, 9-11.

¹⁸³ Sureja Jasin, 81.

¹⁸⁴ Sureja Hakah, 15-18.

¹⁸⁵ Sureja Kehf, 48

(ringjallet për të dhënë llogari). Po, po, do të kthehet te Zoti i tij, me të vërtetë, Ai i sheh të gjitha punët e tij!”¹⁸⁶

Buhariu shënon në Sahihun e tij, nga Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) e cila përcjell se i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Nuk ka njeri i cili do të llogaritet në Ditën e Kiametit vetëm se do të shkatërrohet.” I thashë: “O i dërguar i Allahut, a nuk ka thënë Allahu i Madhëruar: “atij që do t’i jepet libri i tij në dorën e tij të djathtë lehtë do të japi llogari.”¹⁸⁷

I dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) tha: “Në të vërtetë, kjo është shfaqja, porse nuk do të ketë njeri i cili do të merret në pyetje për llogarinë e tij në Ditën e Kiametit veçse do të ndëshkohet.”

Besojmë se secilit njeri do t’i jepet regjistri i veprave të tij, e kur besimtari ta lexojë përmbajtjen e fletushkës së tij, duke përfshirë tevhidin dhe veprat tjera të mira, gëzohet dhe përgëzohet, pastaj e reklamon këtë gëzim; Allahu thotë: **“atij që i jepet libri i veprave të tij në dorën e djathtë, do t’ju thotë (të tjerëve): Qe, lexoni librin, tim; unë kam qenë i bindur se do të paraqes llogari. E, ai është në një jetë të këndshme, në një kopsht të mrekullueshëm, frutet e të cilit janë të ulëta (afër duarve). (Ju thuhet atyre): “Ju bafshin mirë ushqimi dhe pijet për veprat që keni punuar, në ditët e kaluara!”¹⁸⁸**

Ndërsa jobesimtari, hipokriti dhe të devijuarit, atyre do t’u jepet regjistri në dorën e majtë dhe nga prapa shpinës, me ç’rast jobesimtari do të lutet për mjerim e shkatërrim; ashtu siç thotë Allahu: **“Atij që i jepet libri i veprave të tij në dorën e majtë, do të thotë: “Ah, mos të më ishte dhënë libri im, dhe mos të kisha ditur për llogarinë time, Ah, të kisha qenë i vdekur (të mos isha ringjallur)! Pasuria ime nuk më solli dobi, dhe falimentoi fuqia ime! (e atyre u thuhet): “Kapni ata dhe lidhni në pranga, pastaj në skëterrë fërgoni.”¹⁸⁹**

g) Peshorja dhe ura e Siratit:

Ne besojmë në ekzistimin e Peshores; Allahu thotë: **“Dhe Ne, në Ditën e Kijametit do të vendosim peshoja të sakta, e askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi për asgjë edhe nëse është fjala për peshë sa të një kokërre hara dalli (lloj mëlmese), Na do ta sjellim atë (për llogari), e Na jemi të mjaftueshëm për llogaritje.”¹⁹⁰**

Edhe suneti profetik aludon në atë se peshorja e veprave ka dy krahë të prekshëm dhe të dukshëm. Ndërsa peshimi i veprave do të ndodhë pas përfundimit të llogarisë, ngase llogaria do jetë bërë për të konfirmuar veprat, ndërsa peshorja për të treguar sasinë e tyre ashtu që shpërblimi të bëhet sipas saj.

¹⁸⁶ Sureja Inshikak, 6-15.

¹⁸⁷ Sureja Inshikak, 7-8.

¹⁸⁸ Sureja Hakah, 19-24.

¹⁸⁹ Sureja Hakah, 25-31.

¹⁹⁰ Sureja Enbija, 47.

Besojmë edhe në urën e Siratit, e cila është e vendosur mbi Xhehenem, rrugës për në Xhenet, nëpër të cilën do të kalojnë njerëzit varësisht prej veprave të tyre.

Disa prej tyre do të kalojnë për aq sa zgjat një shkrepje e syrit, e disa të tjerë si vetëtimë, të tjerë sikurse era, e prej tyre ka të atillë që do të kalojnë si kalorësi i shpejtë, e disa si të hipur mbi deve, pastaj ka prej tyre që do të vrapojnë e disa të tjerë do të ecin, disa do të zvarriten e disa të tjerë do të kapen e do të hudhen në Xhehenem, ngase ura i ka kangjat e veta me të cilat i kapë njerëzit varësisht prej veprave të tyre; ndërsa ai i cili e kalon siratin, ai do të hyjë në Xhenet.

Ajo çfarë duhet të kuptohet mirë është se, ai i cili është stabil në rrugën e Allahut në këtë botë – e cila është feja e vërtetë – ai do të jetë stabil edhe në rrugën e siratit në Ahiret, ndërsa ai i cili largohet nga rruga e drejtë në këtë botë, nuk do të mund të qëndrojë mbi Siratin e Ahiretit.

Në Siratë, ditën e Ahiretit, hipokritët do të ndahen nga besimtarët, dhe do të mbesin pas tyre, ndërsa besimtarët do të ecin para, dhe mes tyre do të vendoset një mur që do t'i pengojë ata t'u bashkëngjiten besimtarëve.

h) Xheneti dhe Xhehenemi:

Besojmë se Allahu i Madhëruar e ka përgatitur Xhenetin për besimtarët dhe Zjarrin për jobesimtarët; Pra, Xheneti dhe Zjarri që të dyja janë të vërteta, nuk ka dyshim në to. Zjarri është vendbanim i armiqve të Allahut ndërsa Xheneti është vendbanim i miqve të Allahut.

Allahu thotë: **“Nëse nuk mundeni, dhe kurrësi nuk do të mundeni (me i bë shembull Kur'anit), atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Ai është përgatitur t'i ndëshkojë mohuesit. Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira gëzoji me kopshte të xhenetit nëpër të cilat do të kalojnë lumenj çdoherë kur u jepet atyre ndonjë frut i tyre, ata të thonë: “Këtë e kemi ngrënë edhe përpara”, - e atyre do t'u jepen vetëm fruta të ngjashme me to. Në to do të ketë femra të pastra dhe në to do të jetojnë gjithmonë.”**¹⁹¹

Përshkrimi i Xhenetit dhe Xhehenemit, i kënaqësisë dhe dënimit, është bërë në shumë vende në Kuran. Sa herë që përmendet Xheneti kjo pasohet me përmendjen e Xhehenemit, dhe anasjelltas. Herë nxitet për Xhenet dhe ftohet për në të, e herë frikësohet me zjarr dhe dhe kërcënohet me të; Herë tregohet se çfarë kënaqësish janë përgatitur në Xhenet për robërit e singertë, e herë tregohet se me çfarë dënimi të dhembshëm është veçuar Xhehenemi për armiqtë e Allahut.

Besojmë me bindje se Xheneti dhe Xhehenemi janë të krijuara dhe ekzistojnë edhe në këtë moment.

Allahu i madhëruar thotë për Xhenetin: **“është përgatitur për ata që i ruhen Perëndisë (duke punuar vepra të mira).”**¹⁹²

¹⁹¹ Sureja Bekare, 24-25.

¹⁹² Sureja Ali Imran, 133.

Dhe thotë për Zjarrit: **“është përgatitur t’i ndëshkojë mohuesit.”**¹⁹³

I dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush vdes, atij i tregohet vendi i tij në mëngjes e në mbrëmje; poqëse është prej banorëve të Xhenetit, i tregohet vendi i banorëve të Xhenetit, e nëse është prej banorëve të Zjarrit, i tregohet vendi i banorëve të Zjarrit.”¹⁹⁴

Citatet e Kuranit Famëlartë dhe të sunetit profetik rreth pohimit të Xhenetit dhe Xhehenemit janë të shumta. Ehlu suneti dhe xhemati janë unanim për atë se Xheneti dhe Xhehenemi janë të krijuara dhe ato ekzistojnë edhe tani.

Ashtu besojmë edhe se Xheneti dhe Xhehenemi nuk do të zhduken asnjëherë, dhe për këtë aludojnë citatet e Kuranit dhe hadithet e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

Allahu i Madhëruar thotë për Xhenetin: **“frutet e kopshtit janë të përhershme, si dhe freskia e tij.”**¹⁹⁵

Ndërsa i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Kush hyn në Xhenet kënaqet dhe nuk mërzitet më, aty ai është i përhershëm dhe nuk vdes.”¹⁹⁶

Ndërsa prej argumenteve të mbetjes së Xhehenemit dhe mos-zhdukjes së tij është Fjala e Allahut: **“Ata i pret dënimi i përhershëm.”**¹⁹⁷

Dhe fjala e Allahut: **“ata nuk do të dënohen (me vdekje), dhe nuk do të vdesin, dhe as që do t’u lehtësohet dënimi në të.”**¹⁹⁸

O Allah! Kërkojmë kënaqësinë Tënde dhe Xhenetin, dhe fjalë dhe vepra që na afrojnë kah ai; dhe kërkojmë mbrojtjen Tënde nga hidhërimi Yt dhe nga Zjarri, dhe nga fjalët dhe veprat që afrojnë kah ai!

BESIMI NË KADER (CAKTIMIN E ALLAHUT)

a) Kuptimi i besimit në kader:

Bindja e prerë në atë se çdo gjë, e mirë apo e keqe, ndodh me caktimin dhe gjykimin e Allahut të Madhëruar. Ai vepron çfarë dëshiron, dhe asgjë nuk ndodh pos me dëshirën e Tij; asgjë nuk del nga dëshira e Tij, dhe nuk ka asgjë në gjithësi që mund të ikën nga Caktimi i Tij. Askush nuk mund t’i shmanget kaderit, e as nuk mund ta tejkalojë atë që është regjistruar të ndodhë në Lehvi Mahfudh. Ai është Krijuesi i veprave të robërve, të mirat e të këqijat prej tyre, megjithatë Ai i ka urdhëruar ata me obligime dhe i ka ndaluar nga disa gjëra, duke i bërë ata të jenë vetë zgjedhës e jo të detyruar: e bile i ka bërë ato të ndodhin varësisht prej mundit dhe vullnetit të tyre. Allahu është Krijues i tyre dhe i mundësive të tyre, e udhëzon kë të dojë me

¹⁹³ Sureja Bekare, 24.

¹⁹⁴ Buhariu, 3068. Muslimi 2866, Tirmidhiu 1072, Nesaiu, 2070, ibn Maxhe 4270, Ahmedi 2/16, Maliku 564.

¹⁹⁵ Sureja Rad, 35.

¹⁹⁶ Muslimi, 2837. Tirmidhiu, 2525, Ahmedi 2/305.

¹⁹⁷ Sureja Maide, 37.

¹⁹⁸ Sureja Fatir, 36.

mëshirën e Tij, dhe e devijon kë të dojë me urtësinë e Tij. Ai nuk pyetet për atë që Ai vepron, e ata (njerëzit) do të pyeten.

Besimi në Kader është një nga shtyllat e imanit, siç është përmendur në përgjigjen e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) kur u pyet nga Xhibrili (alejhi selam) për Imanin, me ç'rast tha: "ai është të besosh në Allahun, melaqet, librat, të dërguarit, ditën e Fundit dhe të besosh në Kader, të mirë apo të keq."¹⁹⁹

Dhe ka thënë: "Nëse Allahu i Lartësuar do t'i dënonte banorët e qiejve dhe tokës, nuk do t'ishte i padrejtë ndaj tyre, e nëse do t'i mëshironte ata, mëshira e Tij është më e madhe se veprat që ata i kanë bërë. Sikur dikush të posedonte ar sa kodra e Uhudit dhe ta shpenzonte të tërin në rrugë të Allahut, Ai nuk do ta pranonte atë përderisa të mos besojë në kader; Ta dish se ajo që të ka goditur nuk do ka pasur mundësi të mos godiste, dhe ajo që nuk të ka goditur nuk ka pasur mundësi që të të godasë; e nëse vdes jashta kësaj do të hyjë në Zjarr."²⁰⁰

Kader është caktimi i Allahut për krijesat, bazuar në dijen e Tij të mëparshme, dhe sipas asaj që ka aluduar urtësia e Tij.

b) Kategoritë e besimit në Kader:

Besimi në Kader përfshinë katër kategori:

E para: Të besosh se Allahu i Madhëruar ka ditur gjithçka në tërësi dhe në detaje, dhe se Ai i ka njohur të gjitha krijesat e Tij para se t'i krijojë ata; i ka ditur furnizimet, afatin jetësor, fjalët e veprat e tyre, të gjitha lëvizjet dhe moslëvizjet e tyre, fshehtësitë dhe gjërat e dukshme, dhe se kush prej tyre është prej banorëve të Xhenetit e kush është prej banorëve të Zjarrit.

Allahu thotë: **"Ai është Perëndia, që s'ka zot tjetër përveç Tij. Ai i di gjërat e dukshme dhe të padukshme, Ai është mëshirues dhe përdëllimtar."**²⁰¹

Dhe thotë: **"dhe se, me të vërtetë, dijenia e Perëndisë i ka përfshirë të gjitha!"**²⁰²

E dyta: Besimi se të gjitha këto Ai i ka shkruar paraprakisht në Leuhil-Mahfudh, pra se Allahu i Lartësuar ka shkruar paraprakisht të gjitha gjërat, pra për të cilat Ai vetëm se e dinte se do të ndodhin.

Argument për këtë është fjala e Allahut: **"S'ka mjerim (fatkeqësi) që e godet Tokën dhe juve, përveç asaj që ëshë shënur më parë në Libër."**²⁰³

¹⁹⁹ Muslimi, 8. Tirmidhiu 2610, Nesaiu 4990, Ebu Davud 4695, ibn Maxheh 63, Ahmed 1/53.

²⁰⁰ Ebu Davud 4699, ibn Maxheh 77, Ahmed 5/185.

²⁰¹ Sureja Hashr, 22.

²⁰² Sureja Talak, 12.

²⁰³ Sureja Hadid 22.

Si dhe fjala e të dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Allahu i ka shkruar të gjitha përcaktimet për krijesat e Tij pesëdhjetë mijë vite para se t’i krijojë qiejt dhe tokën.”²⁰⁴

E treta: Të besosh në dëshirën e paluhatshme të Allahut, të cilën asgjë s’mund ta kthejë mbrapsht, në Fuqinë e Tij të cilën asgjë s’mund ta pamundësojë; pra të besosh se gjithçka që ndodhë është me dëshirën dhe fuqinë e Tij; ajo çfarë Ai dëshiron ndodh, ndërsa ajo të cilën Ai nuk e dëshiron të ndodhë nuk ndodhë.

Argument për këtë është fjala e Allahut: **“por ju nuk mund të duani, përveç nëse don Allahu.”**²⁰⁵

Dhe fjala e Tij: **“Allahu punon ç’të dojë.”**²⁰⁶

E katërta: Të besosh se Ai, i Lartësuar, është krijues i gjithçkaje; është Krijuesi i vetëm, me ç’rast gjithçka tjetër përveç Tij është e krijuar; dhe se Ai është i plotfuqishëm për çdo gjë.

Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Allahu është krijues i çdo gjëje.”**²⁰⁷

Dhe fjala e Tij: **“dhe i cili ka krijuar çdo gjë, e i ka rregulluar si duhet ato.”**²⁰⁸

Duhet ta dimë se kaderi është Fuqia e Allahut të Madhëruar, dhe se çdo gjë rrjedhë sipas caktimit të Tij; dëshira e Tij gjithmonë zbatohet, prandaj robërit nuk mund të kenë dëshira përveç se ato të cilat Ai i ka dashur për ta, prandaj vetëm ajo që Ai ka dëshiruar për ta ndodh, ndërsa ajo të cilën nuk e ka dëshiruar nuk ndodh.

Ashtu siç duhet ta dimë se esenca e kaderit është fshehtësia e Allahut të Madhëruar për krijesat e Tij, rreth tij nuk di kush, as melekët e afërt të Allahut e as ndonjë profet i dërguar.

Besimtari i vërtetë e përshkruan Zotin e tij me cilësitë e përsosurisë, andaj vëren se ai është i bindur se nuk ndodh ndonjë vepër e që të mos ketë në të një urtësi (të fshehur pas saj); e nëse urtësia hyjnore është e panjohur për të në një çështje prej çështjeve të tij, ai e kupton paditurinë e tij karshi dijes së Allahut – e cila ka përfshirë çdo gjë – dhe e braktis kundërshtimin ndaj të Urtit, të Gjithëdijshtit, Njohësit të gjërave në thellësi, i Cili nuk pyetet për atë që vepron, ndërsa ata pyeten.

c) Të argumentuarit me kader në lënien e urdhërit të Allahut:

Besimi në kader, ashtu siç e kemi përshkruar, nuk e mohon faktin që rob i të ketë dëshira për veprat e tij të përzgjedhshme, apo të ketë mundësi për t’i vepruar ato, sepse edhe feja por edhe realiteti tregojnë se një gjë e tillë është e mundur.

²⁰⁴ Muslimi 2653, Tirmidhiu 2156, Ahmedi 2/169.

²⁰⁵ Sureja Insan, 30.

²⁰⁶ Sureja Ibrahim, 27.

²⁰⁷ Sureja Rad, 16.

²⁰⁸ Sureja Furkan, 2.

Argument për këtë nga feja është Fjala e Allahut të Madhëruar për dëshirën e njeriut: **“e kush të dojë, do ta marr strehimin te Zoti i vet.”**²⁰⁹

Dhe fjala e Tij për aftësinë e njeriut: **“Allahu nuk e ngarkon askend përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bënë, kurse në dëm të tij është e keqja që e punon.”**²¹⁰

Ndërsa sa i përket realitetit, çdo njeri e di se posedon dëshirën dhe aftësinë me të cilat ai vepron apo nuk vepron; ka dallim midis asaj që ai e bën me dëshirën e tij, siç është të ecurit, dhe asaj që ndodh pa dëshirën e tij, siç është kur t'i dridhet trupi; porse dëshira dhe aftësia e robit ndodhin pas dëshirës dhe fuqisë së Allahut; Prandaj Allahu i Madhëruar thotë: **“por ju nuk mund të duani, përveç nëse don Allahu.”**²¹¹ Pastaj, i gjithë universi është pronë e Allahut të Madhëruar dhe nuk ndodh që në pronën e Tij të ngjan diçka pa dijen dhe dëshirën e Tij.

Të besuarit në Kader, siç u bë e njohur më herët, nuk i jep të drejtën njeriut të justifikojë veten në raport me braktisjen e urdhrave të Allahut, apo në veprimin e ndalesave; pra, argumentimi me kader për veprimin e mëkateve është argumentim i kotë, për disa arsye:

E para: i dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Nuk ka ndonjë prej jush e të mos i jetë caktuar vendi i tij në Botën tjetër, Zjarri apo Xhenneti.” Njëri prej të pranishmëve tha: “O i dërguar i Allahut, a të mbështetemi në këtë?” Tha: “Jo! Ju veproni, sepse secilit i është lehtësuar ajo për çfarë është krijuar.”²¹² Pra, i dërguari i Allahut e urdhëroi atë që të punojë (veprojë) dhe e ndaloi atë nga mbështetja në kader.

E dyta: Allahu i Madhëruar e ka ngarkuar njeriun me urdhra dhe me ndalesa, e nuk e ka angazhuar me atë për të cilën nuk ka mundësi; Allahu thotë: **“andaj druajuni Allahut sa të mundeni.”**²¹³

Sikur njeriu të ishte i detyruar (nga Zoti) për çdo vepër të tijën²¹⁴, kjo i bie se ai do të ishte ngarkuar me diçka prej të cilës edhe sikur të mundohej t'i shmangej s'do të mund të lirohej nga ajo, prandaj një teori e tillë është e kotë; prandaj e vërteta është se kur prej robit ndodh ndonjë mëkat, qoftë nga padituria, nga harresa, apo nga të qenit i i detyruar, ai nuk llogaritet mëkatar në këtë rast, sepse është i arsyetuar.

E treta: Kaderi i Allahut është fshehtësi e cila nuk njihet pos pasi që të ketë ndodhur. Vullneti i njeriut për atë që vepron i paraprin veprës porse vullneti nuk është i ndërtuar mbi dijen për kaderin e Allahut prandaj argumentimi i tij me kader është i pavlefshëm; Pra, njeriu nuk ka argument për një gjë të cilën nuk e di.

²⁰⁹ Sureja Nebe, 39.

²¹⁰ Sureja Bekare, 286.

²¹¹ Sureja Insan, 30.

²¹² Buhariu, 6231, Muslimi, 2647, Tirmidhiu, 2136, Ebu Davudi, 4694, Ibn Maxhe 78, dhe Ahmedi, 1/140.

²¹³ Sureja Tegabun, 16.

²¹⁴ Kjo është një provë kundër atyre që pretendojnë se njeriu qenka i detyruar nga Allahu për gjithsecilën vepër të tij, prandaj të veprosh dhe punosh sipas tyre nuk ka ndonjë vlerë.

Nëse një mëkatar kundërpërgjigjet dhe thotë: Edhe mëkati ka qenë i regjistruar për mua. Atëherë atij i thuhet: Çfarë ke ditur ti për dijen e Allahut (atë që të është shkruar) para se ta veprosh mëkatin?! Përderisa nuk e di këtë, dhe ke mundësinë dhe forcën e zgjedhjes, dhe të është bërë e qartë rruga e mirë dhe ajo e keqe, atëherë në momentin që ke bërë mëkat ti je ai që e ke zgjedhur mëkatin, i ke dhënë përparësi atij ndaj bindjes, prandaj do të bartësh pasojat e mëkatit.

E katërta: Ai i cili argumentohet me kader për braktisjen e obligimeve apo veprimin e mëkateve, nëse sulmon një njeri dhe i merr atij pasurinë, e më pas argumentohet me kader dhe thotë: Mos më fajësoni sepse sulmin që kam kryer ka qenë kader nga Allahu, ky lloj argumentimi nuk i pranohet, prandaj si ka mundësi që argumentimi me kader i atij që e sulmon atë të mos i pranohet ndërsa argumentimi për veten e tij edhe në mospëfilljen e të drejtave të Allahut të jetë i pranueshëm?!

d) Gjurmët që lë besimi në kader:

Besimi në kader, edhe pse është pjesë e akides (kredos) dhe shtyllë nga shtyllat e besimit – e cila nëse dikush e mohon del prej fesë – ai gjithashtu lë gjurmë të prekshme në jetën e njeriut. Prej këtyre gjurmëve janë këto në vijim:

- 1- Kaderi është një prej shtytësve më të mëdhenj për një njeri që të veprojë, të jetë aktiv dhe që të përpiqet të arrijë atë që e kënaqë Allahun në këtë jetë; Pra, besimi në kader është prej nxitësve më të fortë që besimtari të punojë, dhe t’iu qaset gjërave më të rëndësishme me bindje dhe përqendrim.

Besimtarët janë të urdhëruar që t’i marrin shkaqet së bashku me mbështetjen në Allahu e Madhëruar, dhe të besojnë se shkaqet nuk japin rezultat vetvetiu por vetëm pasi që Allahu të japë lejen për këtë, ngase Allahu është Ai i Cili i krijoi shkaqet dhe i krijoi rezultatet.

I dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu sesa besimtari i dobët, edhe pse në secilin prej tyre ka hajr; Kujdesu për atë që të bën dobi, kërko ndihmën e Allahut dhe mos u bë i paaftë; Nëse të godet diçka mos thuaj sikur të kisha vepruar kështu e kështu, por thuaj: Ishte caktim i Allahut dhe Ai vepron çfarë të dojë, sepse fjala “sikur të” hap ndikimin (veprimin) e shejtanit.”²¹⁵

Kur muslimanët në të kaluarën merrnin një iniciativë që përmes xhihadit (luftës) të ndryshonin gjendjen e tyre të keqe, ata fillimisht vepronin të gjitha shkaqet e nevojshme për t’u përgatitur për luftë, e më pas i mbështeteshin Allahut të Madhëruar, e assesi nuk thonin mjaftohuni me këtë që kemi se Allahu ka caktuar fitore për muslimanët dhe mposhtje të jobesimtarëve prandaj s’kemi nevojë për përgatitje, për qëndrim në luftë, për durim apo futje nëpër beteja; përkundrazi ata i vepruan të gjitha shkaqet e duhura dhe pikërisht për këtë arsye Allahu u dha atyre fitore dhe përmes tyre e ngriti islamin.

- 2- Prej efekteve të besimit në kader është që njeriu ta njohë vlerën e vetes, të mos bëhet mendjemadh, jofalënderues e kryelartë, duke qenë se ai është i paaftë ta njohë atë që është caktuar për të, atë se çfarë do të ndodh në të ardhmen, e që këtu njeriu kupton dobësinë e tij dhe nevojën e përhershme për Zotin.

²¹⁵ Muslimi, 2664. Ibn Maxhe 79, Ahmed, 2/370.

- 3- Kur njeriun e godet ndonjë e mirë ai bëhet kryelartë dhe krenohet me të, e kur e godet ndonjë e keqe apo fatkeqësi, ai mërzhitet dhe brengoset, porse asgjë s'mund ta mbrojë njeriun nga mendjemadhësia kur goditet nga një e mirë, e as nga mërzhia kur goditet nga një e keqe, përveç besimit në kader, dhe se ajo që ka ndodhur është pasojë e caktimit dhe është paraprirë nga dituria e Allahut.
Njëri prej të parëve të ndershëm ka thënë: "Kush nuk beson në kader, nuk është i kënaqur me jeten e tij."
- 4- Të besuarit në kader i jep fund shumë sëmundjeve prej të cilave janë shkatërruar shumë shoqëri, e të cilat mbjellin mëri në mesin e muslimanëve, siç është smira; Pra një besimtar nuk i ka zili njerëzit për të mirat që Allahu ua ka dhënë, sepse Allahu është Ai i Cili i furnizoi dhe ua caktoi atë atyre, dhe besimtari gjithashtu e kupton se në momentin kur ai ka smirë ndaj të tjerëve, ai në fakt i kundërvihet kaderit.
- 5- Të besuarit në kader mbjell në zemra guximin për t'u ballafaquar me vështirësitë, forcon qëllimet, të bën të qëndrueshëm në fushëbeteja dhe të bën që të mos kesh frikë nga vdekja, për shkak të bindjes se exheli është i caktuar, as nuk ngutet e as nuk vonohet për asnjë moment.
Përderisa ky besim qëndronte thellë në zemrat e besimtarëve, ata qëndruan fort nëpër beteja dhe ishin të vendosur që ta vazhdonin xhihadin; për këtë arsye epopetë e xhihadt bartin shembujt më të bukur të qëndrueshmërisë dhe rezistencës përballë armiqve, sado që ishte fuqia e tyre luftarake, sado që ishte numri i tyre, sepse ata ishin të bindur se njeriun nuk e godet asgjë pos asaj që i është shkruar.
- 6- Të besuarit në kader mbjell në shpirtin e besimtarit disa detyra imanore: ai çdoherë kërkon ndihmë nga Allahu i Lartësuar, i mbështetet vetëm Atij, duke i vepruar shkaqet ai çdoherë është nevojtar ndaj Allahut, prej Tij kërkon ndihmë për stabilitet; ai është gjithashtu bujar dhe e do bamirësinë ndaj të tjerëve; atë e sheh gjithmonë duke u sillur me dhembshuri ndaj tyre dhe duke iu ofruar atyre shërbime të mira.
- 7- Prej gjurmëve që lë besimi në kader tek besimtari është fakti se thirrësi në rrugën e Allahut e shfaqë haptas thirrjen e tij, thërret zëshëm para jobesimtarëve e para zullumqarëve, nuk i frikësohet askujt, u sqaron njerëzve të vërtetën e besimit, u sqaron atyre kuptimin e besimit, sikurse që u sqaron edhe skena të mosbesimit e hipokrizisë, ua tërheqë vërejtjen prej saj dhe ua qet në shesh të kotën dhe gënjeshtren e saj; e thotë fjalën e vërtetë para zullumqarëve. Pra, besimtari e vepron gjithë këtë, me besim të thellë nga zemra e tij, i bindur në Allahun, i mbështetur në Të, duke qenë durimtar ndaj çdo gjëje që i ndodh në rrugën e tij; sepse e di se përcaktimet janë në dorë të Allahut, të Vetmit, dhe se furnizimi është tek Ai; dhe se krijesat nuk posedojnë asgjë sado që ata të zotrojnë fuqi e aftësi.

Kjo ishte e tëra, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dërguarin e Tij, Muhamedin, mbi familjen dhe gjithë shokët e tij!